

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7717 E enjte 22 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Mesazhi

Ditës

Nga BERND BORCHARDT

**T**ë dashur miq dhe të ftuar! Prezenca e OSBE-së në Shqipëri është e përfshirë në zhvillimin e medias në Shqipëri që prej 21 vjetësh. Ndër të tjera, ne ...

Vijon në faqen 20

OSBE mirëpret angazhimin e Ramës për lirinë e medias



Analiza

Ditës

Nga GJERGJ EREBARA

**K**atër segmente rrugësh të reja dhe një kontratë mirëmbajtjeje të dhëna me koncesion deri tani pritet t'i kushtojnë taksapaguesve 153.8 miliardë lekë ....

Vijon në faqen 21

Thesi 1.2 miliardë euro koncesione te rrugët



Përplasja mes Ismet Beqirajt e Gjoknurit

## "Po na shohin si të njerks", debatet mes deputetëve të PS-së për buxhetin e 2019

Deputeti i Mallakastrës: Janë hequr 2 objekte. Braçe replikon: S'po të shoh njeri si të vjehrrës

VALENTINA MADANI

Banorët e zonës së "Astirit" pavarësisht motit të keq, edhe dhe protestuan duke bllokuar rrugën tek Unaza e Re shumë herë më të vendosur për të mos u tërhequr pa marrë garancinë për dëmshpërblimin ...

Në faqen 3

## PUNONJESIT E NENTOKES NESER NE PROTESTE: TE MIRATOHET SHITESA

# PENSIONET E MINATOREVE, SA RRITEN PAS "STATUSIT"

Ish-punonjësit e minierave marrin 140 mijë lekë të vjetër pension, po u miratua drafti, përfitojnë 80% më shumë. Flasin: Ded Marku, Ali Çausi e Gjergj Marku



(Në foto) Minatorë në protestë. Ded Marku, Ali Çausi, Gjergj Marku

PROTESTA TE UNAZA E RE

**Banorët: Pronat do t'i mbrojmë me gjak. Rama: Jo shpronësim për zaptuesit e tokës**

Në faqen 4

ZBULOHEM MESAZHI

**Letër nga burgu deputetit Ervin Salianji: Do të vritesh me snajper**

Në faqen 7

KRITIKA

**Dhimbja si art në poezinë danteske të Flutura Açkës**

Në faqen 18

LETËRSI

**Proza letrare e Lumos Skëndos, një përmbledhje nga Uran Butka**

Në faqen 12-13

TAKIMI/ DY PRESIDENTET NDEROJNE SKENDERBEUN



**Meta-Kitaroviç: Partneritet strategjik Shqipëri-Kroaci**

Në faqen 5


Botimi i UET/ Ish-ambasadori ynë në Greqi publikon përshtypjet personale e profesionale

## "Miqësi e trazuar", Greqia në kujtimin e Bashkim Zenelit

"Inva Mula ngriti në këmbë Athinën, Tirana s'na njoftoi për ardhjen e saj"

NGA BASHKIM ZENELI

**D**iva Inva Mula ngreleshë Athinën. Më 1 tetor 2003, jo vetëm shqiptarët në Athinë, por edhe grekët dhe të huajt në kryeqytetin helen do të përjetonin një ngjarje të madhe kulturore dhe artistike: Inva Mula, sopranoja shqip-



tare me famë botërore, do të këndonte në Teatrin Antik Herodion të Athinës. Shtypi kishte disa ditë që i bënte jehonë kësaj ngjarjeje dhe vetëm kjo na bëri që, meqë nuk kishim djeneri si ambasadë, të kontaktonim me organizatorët për çdo detaj ...

Në faqen 10-11

## UNAZA E MADHE PROTESTA

Banorët e Unazës së Re paralajmërojnë kryeministrin: Pronën do ta mbrojmë me jetë!

# Unaza, protestuesit: Na dëgjoni, ose do hyjmë brenda në Kuvend

"Zgjidhja": Jemi me qytetarët, poshtë neodiktatorët!

Valentina Madani

Banorët e Unazës së Re dolën sërisht dje në protestë, duke kërkuar dëshmipërbllim për prishjen e banesave që preken nga projekti. Ata bllokuan aksin tek Unaza e Re, që lidh Pallatin me Shigjeta dhe sheshin "Shqiponja". Banorët e "Astirit" siguruan se asgjë nuk do t'i ndalë të mbrojnë banesat e tyre, qoftë edhe me gjak. "I bëj thirrje të gjithë popullit shqiptar që të ngrihen se kjo është një kauzë për gjithë Shqipërinë që po ikën drejt humnerës. Po ikin njerëzit jashtë. U bëj thirrje të gjithë ambasadave. O kryefaqezi, pronën do ta mbrojmë me gjak, me jetë! Ti do të më vrasësh mua, pas meje do të vish dhe ti. Do të vdes për pronën time. Vetëm mashtrome ke bërë me këtë popull, por nuk na shtyp dot. Po na vrave ne, do të dalin edhe të tjerët më të fortë se ne dhe ti me ne e ke fundin, ta kesh të qartë. Lëri lojërat politike se nuk jemi për politikë, jemi për të drejtën tonë legjitime. Avokati i Popullit të mos flejë gjumë, u bëj thirrje të gjithë ambasadave, shoqatave të të drejtave të njeriut, të vinë tani sa nuk është vonë. Më vonë nuk e di çfarë do të bëhet, do t'i mbrojmë me gjak pronat tona. Jemi të gjithë të bashkuar dhe nuk na përçani dot", tha njëri nga protestuesit. Ata kërkuan largimin e Edi Ramës nga qeveria. Një nga protestuesit i kujtoi kryeministrin se nuk do lejojë që të t'i prishet banesa duke thënë: "Edi Rama duhet të ketë kujdes, se ka një fjalë që thotë 'e vogla sjell gjithmonë të madhen". Banorët e "Astirit" paralajmëruan se nëse nuk merrn parasysh kërkesat e tyre për dëshmipërbllim, sot do të protestojnë para parlamentit, madje duke kërcënuar se do të hyjnë edhe brenda në Kuvend. "I bëj thirrje kryeministrin, që nesër (sot) protesta

do të jetë përpara parlamentit dhe nëse nuk dëgjoni, ne mund të futemi edhe brenda në Kuvend. Prandaj në orën 10 do të jemi të gjithë përpara parlamentit të mbështetur dhe nga banorët

e bregut të lumit", shtoi një tjetër qytetar. Me banorët dje u solidarizua dhe partia "Zgjidhja" e Koço Kokëdhimës. "Ne jemi me qytetarët, sepse ligji është me qytetarët. Të gjithë ata që

kanë ndërtuar para vitit 2013, të gjitha banesat janë të ligjshme. Në rast se ka një plan për riurbanizimin e Tiranës, shteti ligjor është i detyruar t'i pranojë si të ligjshme ndërtimet që janë bërë para 2013-ës. T'u japë tapitë qytetarëve dhe t'i rimburojë sipas ekonomisë së tregut për aq sa u takon. Atyrë që kanë dyqane apo ente tregtare t'u japë për një vit qiranë lidhur me fitimin që u takon. Ndërsa qytetarët të cilët për arsye të interesit publik do të largohen nga këto troje dhe të shpronësohen me vendim, atyre t'u jepen jo vetëm paratë për pronën e ligjshme, por edhe dy vjet qira për shtëpitë. Përpara se të bëjnë ndërtimin e ndonjë shtëpie tjetër, qytetarët duhet të kenë kohën e tyre", deklaroi z. Vladimir Lulaj, nënkryetar i partisë "Zgjidhja".



Protesta e djeshme e banorëve tek Unaza e Re

## Unaza, Kryemadhi-Ramës: Në ç'vënd të botës 2 km kushtojnë 40 mln euro

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, hodhi akuza të forta dje mbi qeverinë për koston e Unazës së Madhe. Ajo akuzoi se kryeministri Rama po mbron oligarkët e tij për çmimin stratosferik të projektit. Kryemadhi kërkoi nga kreu i qeverisë të tregojë se në ç'vënd të botës 2 km kushtojnë 40 milionë euro. "Dhe së fundmi një kujtesë, meqë dijepaku përmend manualin: manual në shqipe të pastër është doracak dhe në shqipen e përditshme është doracak në xhepat e buxhetit të shtetit, të atij buxheti që gllabërohet çdo ditë nga Edi Rama dhe klientët e tij", - shkruan Kryemadhi. Ajo e quajti Ramën si "kryeministër injorant, që librin e aritmetikës e ka mbyllur që në klasën e



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

katër fillore". "Kryeministri injorant, që librin e aritmetikës e ka mbyllur në klasën e katër fillore, është përpjekur të mbrojë okigarkët e tij të babëzitur për çmimin stratosferik për ndërtimin e Rrugës së Unazës. Ky frikacak i pashembullit le të tregojë se në ç'vënd të botës 2 km kushtojnë 40 milionë euro, le të tregojë qartë projektin dhe firmat që përfi-

tojnë nga ky palaçollëk. Dhe së fundmi një kujtesë, meqë dijepaku përmend manualin, manual në shqipe të pastër është doracak dhe në shqipen e përditshme është doracak në xhepat e buxhetit të shtetit, të atij buxheti që gllabërohet çdo ditë nga Edi Rama dhe klientët e tij", shprehet kryetarja e LSI.

### PETRIT VASILI

"Kryeministri i Shqipërisë duhet të turpërohet dhe para çdo deklarate tjetër duhet t'i kërkojë falje 1000 herë qytetarëve, pasi i mashtroi për t'i marrë votën. Sot sipas tij, ata s'kanë asnjë të drejtë, por u dashkan të dalin në mes të 4 rrugëve", tha z. Vasili.



## "Parti shpelle", Berisha-Veliajt: Gropën e bëjnë lulishte

Kryebashkiaku Erion Veliaj publikoi dje një foto nga Tirana gjatë kohës së qeverisjes demokratike. Në foto shihet grupa "Sejdia", me të cilën Veliaj ironizon PD-në. Ai thekson se opozita e tanishme kur ishte në pushtet, ishte kail ta kthehte të gjithë qytetin në gjiriz veç për një grusht votash, ndërsa siguron se një gjë e tillë nuk do të ndodhë kurrë më. "Urban Pool". Një foto e Tiranës nga Robert Pischler në zenitin e qeverisjes SHQUP-ore të kryeqytetit. Kur i referohem 'partisë së shpellës', kam parasysh lehtësinë e papërbalueshme me të cilën janë kail ta kthejnë qytetin në gjiriz veç për një grusht votash! #NeverAgain", shkruan Veliaj. Ish-kryeministri Sali Berisha reagoi pas komentit të kryebashkiakut Erion Veliaj për të ashtuquajturën "gropa" e Tiranës. Berisha i kujton se atë që Rama e mbajti ashtu për 5 vite, ishte bashkia me kryetar Lulzim Bashën që e ktheu në lulishte. "Kallam Dëshatukut, Lal Plehut, Sugar Parukes! O të pafytyrë që brohorisni mashtrimin dhe pafytyrësinë tuaj. Po gropën që mbajti si qenof të kryeqytetit për pesë vite Edvin Kristaq Thuapisi, harruat si protestuat kur qeveria e PD e mbyllti atë dhe më vonë bashkia e PD e ktheu në lulishte", - shkruan Berisha.



Kryeministri ka akuzuar banorët se kanë ndërtuar deri në 8 godina pa leje

# Edi Rama: Nuk ka shpronësim për zaptuesit profesionistë, lironi rrugën

*"Të kesh aplikuar, nuk do të thotë të legalizohesh"*

Qeveria është e vendosur që pavarësisht protestës së vazhdueshme të banorëve të "Astirit", ta çojë deri në fund projektin për zgjerimin e Unazës në segmentin nga mbikalimi pranë Pallatit me Shigjeta deri te Dogana. Ndonëse e ka rezervuar gjatë seancës së sotme plenare përgjigjen më të zgjeruar për këtë çështje, kryeministri Edi Rama ka konfirmuar dje se projekti nuk do të ndalet dhe se ata që i kanë shtëpitë apo bizneset e tyre pa leje, do të marrin vetëm bonus qiraje dhe nuk do të shpronësohen.



Kryeministri Edi Rama dje gjatë takimit për platformën e bashkëqeverisjes

**NDËRTIMET**  
"Kemi njohur një kategori deri dje të panjohur, edhe pse ka ekzistuar, kategorinë e zaptuesve profesionistë të pronave publike, apo të pronave të tjetërkujt. Individë që rezultojnë me nga 4, 5 dhe deri 8 ndërtime pa leje në Tiranë, në bregdet, apo në zonat nga ku kanë ardhur".



**Gjoknuri: Projekti për 100 vitet e ardhshme, s'ka prishje pa VKM**

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë Damian Gjoknuri nga Komisioni i Ekonomisë ku ishte i pranishëm për projektbuxhetin ka folur edhe për çështjen e projektit të zgjerimit të Unazës së Madhe dhe protestën e banorëve që preken prej saj. Ministri Gjoknuri u shpreh se gjurma e projektit ka qenë e konceptuar që në 1989, ndërsa shtoi se objektet nuk do të prishen pa dalë vendimi i qeverisë për shpronësimet, ndërsa në ditët në vijim do të nisë vlerësimi i objekteve. "Projekti vijon gjurmën e nisur. Është autostradë e karakterit urban dhe nevoja që ky projekt ka pasur për rrugë paralele është pasi nuk mund të bëjmë unazë që ndajnë qytetin në mes pa krijuar lidhje. Projekti është i komplikuar dhe i shtrënjtë. Është i plotë dhe me parametra jashtëzakonisht të mirë. Do të qëndrojë për 100 vitet e ardhshme. Ka pasur një spekulim të madh politik, nuk ka filluar proces prishje, gjithçka është e stisur. Nuk ka pasur procedurë njoftimi për banorët. Nuk ka prishje pa një vendim të Këshillit të Ministrave për shpronësimet", tha Gjoknuri.



**ARRSH, tri grupe pune për vlerësimin e banesave që preken**

Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) ka ngritur tri grupe pune për vlerësimin e banesave që preken nga projekti i Unazës së Madhe. Sipas ARRSH, grupet e punës janë ngritur për shpronësimet në segmentin rrugor nga 'Pallati me Shigjeta' deri te "Dogana". Grupet e punës do bëjnë matjet dhe vlerësimin për pasuritë që preken nga projekti dhe drejtohen nga Ermal Shena, Olsi Mema e Ilir Gjorgja, ndërsa kanë secili nga 8 anëtarë. Detyrat e grupeve, sipas urdhrat që mban firmën e kreu të ARRSH-së, janë: matja dhe vlerësimi i të gjitha pasurive që preken nga projekti; kryerja e të gjitha korrespondencave me institucionet shtetërore për marrjen e dokumentacionit dhe konfirmimeve që nevojiten për plotësimin e kërkesës për shpronësim; plotësimin e kërkesës për shpronësim për të gjitha pasuritë pronë private sipas legjislacionit në fuqi dhe dorëzimin e kërkesës për shpronësim brenda muajt dhjetor.

## Qendro: Disa objekte mund të prishen pjesërisht

### Punimet tek Unaza e Madhe, ja si devijohet qarkullimi i makinave

Ndërsa janë ende në pritje të daljes së Vendimit të Këshillit të Ministrave për të shpronësuar objektet me leje, institucionet shtetërore kanë nisur përgatitjet për të nisur punimet e rrugës. Për këtë qëllim dje Autoriteti Rrugor Shqiptar, Bashkia e Tiranës, Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake kanë marrë masat për të mundësuar devijimin e trafikut me qëllim që të mos pengohen punimet. Në një dalje të përbashkët për mediat të katër këto institucione, kanë sqaruar qytetarët përdorues të rrugës, se qarkullimi i mjeteve në Unazë të Madhe nga Pallati me Shigjeta deri te Dogana do të bëhet në mënyrë të alternuar në varësi të punimeve. Afrim Qendro, drejtor i ARRSH-së bëri me dije, gjithashtu, se sheshi 'Shqiponja' nuk do të jetë më rrethrotullim, por një gjysmë unazë dhe makinat që vijnë nga rruga "Dritan Hoxha" për t'u futur në Unazë du-



het të shkojnë deri te kthesa e Kamzës dhe më pas të kthehen. "Do ketë tri korsi, në ikje dhe në ardhje duke nisur nga muaji janar. Kantieri do të zhvillohet nga pjesa e Astirit, ku kemi pak ndërtesa që preken. Do funksionojë të gjithë semaforët. Kur vjen nga unaza nuk mund të rrotullohet në vend, por do shkosh deri tek Casa Italia", tha Qendro. Po ashtu Qendro tekta u ndal tek dëshpërbllimi i qytetarëve, të cilët prej disa ditësh protestojnë, tha se do të bëhen

të gjitha vlerësimet e objekteve. "Ka shumë objekte që nga verifikimi mund të riformatohen. Në këto raste në bazë të ligjit do të bëjmë vlerësim bashkë me qytetarët të objektit, ku do të jepet aprovim që kjo banesë mund të qëndrojë në këmbë, që do të thotë pjesa që preket do të prishet dhe pjesa që mbetet do të vijojë të qëndrojë", pohoi ai. Ai u shpreh i gatshëm që të takojë një përfaqësi të banorëve, por vetëm duke respektuar institucionet.

banese apo çfarëdo lloj ndërtese nuk do të thotë se në këtë rast kemi të bëjmë me proces legalizimi. "Të kesh aplikuar për legalizim, nuk do të thotë të legalizohesh medoemos, nëse ngrehina jote bie në shtratën e rrugës, bie në një zonë arkeologjike, bie mbi tubacionet e ujësjellësit, të kanalizimeve, apo aty ku

kalojnë linjat e energjisë elektrike e kështu me radhë", u shpreh Rama. Ndaj, ai u bëri thirrje banorëve që "të largohen nga rruga që kanë bllokuar dhe t'i hapin rrugë zhvillimit dhe të mos turpërojnë veten dhe familjen e tyre, duke u bërë për më tepër gazi i botës dhe mish për top të atyre të tjerëve".

Kryeministri Edi Rama u është kundërpërgjigjur me ironi edhe akuzave të opozitës se po harxhohen më shumë para se duhen për rrugën e Unazës së Madhe, duke u shprehur se vlerat për kilometër variojnë sipas përmbajtjes së projektit e çmimet dalin nga një manual standard.

## PROJEKTI AKUZAT

Kreu i PD-së u premtonte studentëve: Anulojmë ligjin për arsimin e lartë

# Basha: Projekti i Unazës korruptiv, shpronësimi garantohet me ligj

"Po shkelet ligji, duan të prishin 370 banesa"

Valentina Madani

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ishte dje i pranishëm në një takim me studentët në Forumin "Studentët për qeverisjen e mirë". Z.Basha u premtonte studentëve se kur të vijë opozita në pushtet, do të ketë rritje të buxhetit për arsimin dhe të gjithë të rinjtë dhe të rejtat do të kenë mundësi për t'u arsimuar, pavarësisht shkallës ekonomike. "Do ta anulohet ligjin për arsimin e lartë, do ta dyfishojmë buxhetin për arsimin e lartë. Nëse do të kisha një mundësi për të shtuar buxhet, unë do të shtoja tek arsimi i lartë, pasi nga aty nis gjithçka. Ne do t'i mundësojmë çdo të riu dhe të reje shqiptare që të ndjek studimet e larta, pa marrë parasysh buxhetin e familjes së tij. Po ashtu, kemi edhe programin e stazheve të punës për 10 mijë të rinj. Për një vit do të ketë një punë me 300 mijë lekë të paguara nga shteti", deklaroi kreu i PD-së.

**UNAZA**  
Para studentëve, kreu i opozitës denoncoi projektin e qeverisë për ndërtimin e Unazës së Madhe. Sipas tij, ky projekt u bë pa garë dhe pa transparencë. Kreu i PD, Lulzim Basha deklaroi në forumin "Studentët për qeverisjen e mirë" se projekti për Unazën e Re është një projekt korruptiv. Sipas Bashës, shpronësimi i banorëve që preken nga projekti është i garantuar me ligj, por ligji shkelet nga vetë shteti dhe qeveria. "Kanë bërë një projekt dhe duan të prishin 370 banesa. Projekti është me tender korruptiv dhe nuk ka pasur garë. 40 milionë euro për 2 km rrugë. I pyeti njeri banorët dhe inxhinierët? Askush nuk u konsultua. Ligji është shkelur me të dyja këmbët nga vetë shteti dhe qeveria. Është shkelur ligji, sepse shpronësimi i banorëve është i garantuar me ligj. E treta është transparenca. Pse duhet të shkojnë ato para



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

### AKUZA

"Kanë bërë një projekt dhe duan të prishin 370 banesa. Projekti është me tender korruptiv dhe nuk ka pasur garë. 40 milionë euro për 2 km rrugë. I pyeti njeri banorët dhe inxhinierët? Askush nuk u konsultua. Ligji është shkelur me të dyja këmbët nga vetë shteti dhe qeveria. Është shkelur ligji, sepse shpronësimi i banorëve është i garantuar me ligj", tha kreu i PD-së.

## Drejtoria e Burgjeve: Xhuvani kreu një operacion

### Denoncimi të Berisha: Vrau 5 veta, lirohet Kostandin Xhuvani

Në një mesazh të qytetarit dixhital, dërguar ish-kryeministrit Sali Berisha thuhet se Kostandin Xhuvani është liruar nga burgju. Djali i ish-deputetes së PS-së, Luiza Xhuvani, vuan dënimin me 35 vjet burg për vrasje të katërfishtë, ngjarje e ndodhur në 2014-ën. Por në mesazhin në fjalë pretendohet se, pasi iu nënshtrua një operacioni në Qendrën Spitalore "Nënë Tereza", Xhuvani nuk është kthyer më në burg. Teksa poston këtë mesazh, ish-kryeministri Berisha e konsideron këtë ngjarje një superskandal. "Rama liron nga burgju vrasësin e dashur serial të organizatës kriminale 'Rilindja', Kostandin Xhuvani. Motivi: Kosta ka vuarë 5 të rinj, por është xhani i partisë!", shkruan Berisha, ndërsa bashkangjitur sjell edhe mesazhin e qytetarit dixhital: "Përsëritet Dr. Kostandin Xhuvani, vrasë-



si i 5 të rinjve nuk është më në burg. Para dy javësh, Kosta ka qenë në QJST, është bërë operim nga doktori për apendicitin dhe në dallim nga të burgosurit e tjerë që trajtohen në spital, apo që edhe vdesin pa kurrfarë ndihme, atë me urdhër nga Rama e kanë marrë familjarët brenda ditës nga spitali, është operuar natën dhe e kanë marrë direkt familjarët. S'është regjistruar fare në regjistrat e spitalit të burgut dhe nuk



### DËNIMI

Djali i ish-deputetes së PS, Luiza Xhuvani, vuan dënimin me 35 vite burg për vrasje të katërfishtë, ngjarje e ndodhur në 2014-ën. Por në mesazhin në fjalë pretendohet se, pasi iu nënshtrua një operacioni në Qendrën Spitalore "Nënë Tereza", Xhuvani nuk është kthyer më në burg.

është në burg, me ndërhyrje nga vetë Rama është liruar nga burgju, nën pretekstin e operacionit". Por në një reagim të Drejtorisë së Burgjeve thuhet se kjo është totalisht e pavërtetë. Në deklaratë s'qarohet se Xhuvani ka kryer një ndërhyrje kirurgjikale në QJST, i shoqëruar nga punonjësit e policisë së Burgjeve dhe menjëherë pas kësaj, ai është transferuar në spitalin e burgut.

ndihmat sociale për familjet në nevojë. 290 mijë shqiptarë sot hanë një vakt në ditë se nuk kanë mundësi".



Presidenti i Republikës, Ilir Meta gjatë vizitës së djeshme në Kroaci me homologen kroate, Kolinda Grabar-Kitarović

## Zgjedhjet në PD, Bozdo: Kemi garë dhe rivalitet

Sekretari organizativ i Partisë Demokratike, Enno Bozdo shprehet i sigurt se zgjedhjet e brendshme të do ta bëjnë më të forte partinë më të madhe të opozitës. Kjo siguri e Bozdos vjen nga një motiv. "Sikur të mos kishim, kjo do të jepte shenjat e një organizate që është në fjetje. Por ka garë", - tha Bozdo për "News 24". E gjithë procedura e zgjedhjeve të brendshme në parti sipas sekretariatit organizativ të PD-së është bërë në bazë të statutit të ri, i cili ka marrë miratimin e anëtarësisë. Teksa pranon mendimet ndryshe për zhvillimin ose jo të zgjedhjeve, Bozdo thotë se vendimi për t'i zhvilluar ato tani është më i drejti. Synimi i të gjithë këtij procesi sipas Enno Bozdos është që Partia Demokratike të dalë përpara shqiptarëve me një alternativë të qartë dhe të besueshme përballë një qeverie të korruptuar dhe të lidhur me krimin. Proceset zgjedhore për të zgjedhur kryetarët e partisë demokratike në rrethe sipas një urdhri të Lulzim Bashës do të mbahen nga data 23 nëntor deri më 2 dhjetor, për t'i hapur rrugë më pas Kuvendit Kombëtar.



## Këlliçi: I ati i nënkryetarit të FRESH denon aktivistin e PD

Kreu i FRPD-se, Belind Këlliçi në një deklaratë për mediat u shpreh: "Anëtar i FRPD, Oleg Gora u dënua politikisht nga gjyqtari Arben Micko, babai i nënkryetarit të FRESH-it, Artur Micko, pasi gjuajti me vezë Erjon Veliajn, sepse ishte kundër prishjes së Teatrit Kombëtar". Këlliçi tha se, "gjyqtari politik i Rilindjes, Arben Micko, vendosi se të gjuash me vezë Erjon Veliajn është prishje e qetësisë publike. Edi Rama liron trafikantët e kriminelët dhe dënon të rinj", deklaroi ai, duke garantuar se, "nuk kemi për t'i lënë të qetë që të shkatërrojnë vendin dhe të ardhmen tonë". Në gershor të këtij vit një i ri gjuajti me vezë në drejtim të kryebashkiakut të Tiranës, Erjon Veliaj. Partia Demokratike në një deklaratë ka akuzuar kryeministrin Edi Rama se liron trafikantët e drogës dhe po dënon të rinjtë që protestojnë për të drejtat e tyre. Belind Këlliçi, kryetari i FRPD, u shpreh se Oleg Gora u dënua politikisht, pasi qëlloi Veliajn në shenjë proteste kundër prishjes së Teatrit Kombëtar.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta gjatë vizitës në Kroaci u prit në një takim të veçantë nga homologia kroate, Kolinda Grabar-Kitaroviç, ku diskutuan mbi thellimin e marrëdhënieve dypalëshe në të gjitha fushat. Presidentja Grabar-Kitaroviç ripërsëriti mbështetjen e palëkundur të Kroacisë dhe të sajën personale për integrimin evropian të Shqipërisë dhe të shqiptarëve në gjirin e familjes së madhe europiane. Ndërsa, Presidenti Meta shprehu vlerësimet më të mira për marrëdhëniet e shkëlqyera janë model në rajonin tonë, sepse mbështetjen në lidhje e forta historike mes dy kombeve dhe vizionin e përbashkët drejt së ardhmes euroatlantike, Presidenti i Republikës nënvizoi faktin se të dyja vendet anëtare të NATO-s ndajnë jo

Presidenti vizitoi "oazin e shqiptarëve në Kroaci"

Meta-Kitaroviç: Partneritet strategjik mes dy vendeve



vetëm sfidat, por edhe përgjegjësitë për paqen dhe sigurinë si dhe për zhvillimin ekonomik në Europën Juglindore dhe hapësirën Adriatiko-Joniane. "Janë arsye të genëshme që marrëdhëniet tona të ngrihen në nivelin e partneritetit strategjik dhe të forcohen në interes të një bashkëpunimi

edhe më cilësor", u shpreh Presidenti Meta. Ndërkohë që në kuadër të Vitit Kombëtar të Heroit tonë Gjergj Kastriotit Skënderbeut, të dy presidentët vizituan bashkësinë e Arbanasve të Zarës, "oazin e shqiptarëve në Kroaci", ku u takuan me përfaqësuesit arbanas, me prefektin dhe kryetarin e Bashkisë së Zadarit, autoritetet vendore dhe drejtuesit fetarë. "I mbushur me emocione mes arbanasve të Zarës, kësaj pjesë të rëndësishme të trugut të lashtë të popullit tonë në brigjet e Dalmacisë, këtij "oazi të shqiptarëve në Kroaci", shkruan kreu i shtetit rreth kësaj vizite.

Gjikhuri deklaroi se punimet për rrugën Tiranë-Elbasan do mbyllen në pranverë

Debati në komision, deputetët të pakënaqur me investimet

"Mallakstra si e njerks, nuk ka asnjë investim"

Deputetët socialistë kanë jo pak rezerva dhe pakënaqësi për investimet në zonat e tyre dhe projektet infrastrukturorë që parashikon buxheti i vitit 2019. Madje, këto pakënaqësi nuk ngurojnë t'i shprehin edhe hapur në sy edhe të mediave, siç edhe ndodhi dje në Komisionin e Ekonomisë, ku i ftuar ishte ministri i Infrastrukturës, Damian Gjikhuri. Duke marrë shkas nga prania e ministrit të Infrastrukturës, deputeti Ismet Beqiraj i ka drejtuar atij një sërë pyetjesh lidhur me investimet që prekin Mallakstrën, zonën e tij zgjedhore. Por Gjikhuri është përpjekur t'u shmangej pyetjeve të detajuara, duke theksuar se prioriteti i qeverisë kanë qenë investimet në rrugët kryesore, që kanë edhe një fluks më të madhe lëvizjeje. "Ne do bëjmë investim deri në rangun e 1.4 miliardë dollarëve në infrastrukturë rrugore, por mundësitë këto janë dhe kërkesat janë shumë më të mëdha. Prandaj kemi praktikuar dhe PPP që rrugët t'i kemi tani. Kështu që më mirëupto në këtë drejtim. Investim është hedhur vetëm në rrugë nacionale me intensiteti trafiku", tha Gjikhuri. Por, deputeti Beqiraj ka këmbëngulur që të marrë një përgjigje konkrete nga Gjikhuri sa i përket një sërë çështjesh. "Nuk ju përgjigjet pyetjes që për mua është shumë e rëndësishme. Zona e Mallakstrës nuk ka asnjë objekt të ri në vitin buxhetor 2019", tha deputeti Beqiraj. Në debat është përfshirë edhe kryetari i komisionit, Erion Braçe, i cili i kujtoi deputetit Beqiraj se



Mbledhja e djeshme e Komisionit Parlamentar të Ekonomisë

TIRANË-ELBASAN

"Në fund të shtatorit parlamenti miratoi kredinë për këtë rrugë. Afati është dhjetori, por mund të ketë edhe shtyrje disamujore, sepse kjo varet edhe nga kushtet atmosferike. Si përfundim i veprës mund të them se do të jetë pranvera e vitit të ardhshëm", tha Gjikhuri.

mbledhja e komisionit nuk ishte për të trajtuar problematikat e zonave elektroale. Por, as kjo nuk e ka ndaluar deputetin e Mallakstrës, teksa i ka kujtuar Braçes se ai personalisht i ka zgjidhur çështjet infrastrukturorë të zonës së tij në Divjakë. Ai ka deklaruar se Mallakstra sa u përket investimeve, po trajtohet si e njerks. Ndërkohë që gjatë kësaj mbledhjeje, ministri

Gjikhuri bëri të ditur se rruga Tiranë-Elbasan do të përfundojë vetëm brenda pranverës së ardhshme. "Në fund të shtatorit parlamenti miratoi kredinë për këtë rrugë. Afati është dhjetori, por mund të ketë edhe shtyrje disamujore, sepse kjo varet edhe nga kushtet atmosferike. Si përfundim i veprës mund të them se do të jetë pranvera e vitit të ardhshëm", tha Gjikhuri.

DEBATI

BEQIRAJ: Nuk ju përgjigjet pyetjes, që për mua është shumë e rëndësishme. Zona e Mallakstrës nuk ka asnjë objekt të ri në vitin buxhetor 2019. Dhe e dyta...

ZOTI BEQIRAJ...

BEQIRAJ: Të lutem, të lutem...

BRAÇE: Jo, mos mu lut fare, këtë mbledhje e drejtoj unë.

BEQIRAJ: Të lutem, jo ka hequr dy objekte Erion, ujësjellësin e fshatit Visokë dhe ujësjellës-kanalizime.

BRAÇE: Zoti Beqiraj, edhe një herë tjetër, për zonat elektorale keni mbledhjen e grupit parlamentar, keni edhe seancën plenare, shkoni atje dhe bisedoni për zonat individuale të gjithsecilit. Këtu, nëse u bënë pyetje, u bënë pyetje për projekte madhore.

BEQIRAJ: Të lutem, ore kanë qenë në ligj dhe janë hequr.

BRAÇE: Nuk është ky komision për zonat elektorale.

BEQIRAJ: Ai s'ka pse t'i heqë.

Beqiraj: Duhet të shfuqizohen dy ligje, është ministër ai.

BRAÇE: Shko shfuqizo.

BEQIRAJ: Nuk dua që të shikohet me syrin e njerks Mallakstra. Kaq po të them.

BRAÇE: S'po të shikon njeri as me syri e njerks dhe as me syrin e vjehrit.

Qeveria "shurdhe" ndaj FMN-së, rrugë të tjera me pagesë

Veç Rrugës së Kombit dhe autostradës Tiranë-Durrës, qeveria duket se po planifikon që edhe akset e tjera nacionale t'ia japë privatit për mirëmbajtje apo rehabilitim. Në mbledhjen e djeshme të qeverisë, janë bërë disa ndryshime në vendimin e mëparshëm për koncesionet, i cili në fakt sjell lehtësira të tjera për biznesin privat, që përfshihet në marrëveshje koncesionare. Qeveria ka vendosur që nëse propozimi i pakërkuar konsiderohet i pranueshëm, autoriteti kontraktor mund të nisë procedurën për dhënie e kontratës nëpërmjet një procesi transparent dhe konkurrues. Në mesin 15 shpërgohet dhënia e bonusit për atë kompani që do të marrë një koncesion për mirëmbajtjen e rrugës. "Në rast pranimi të një propozimi të pakërkuar, përpara procedurës konkurruese, propozuesi ka të drejtë të përfitojë nga autoriteti kontraktor; i cili vendos për një nga format e mëposhtme të bonusit: një bonus për rezultatit tekniko-financiar të propozuar prej tij, deri në një maksimum prej 10% të vlerësimit maksimal të garës, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, vendimi parashikon edhe aplikimin e procedurës me publikim të projektit të tij, me qëllim përfitimin e ofertës më të leverdisshme ekonomike, pa ndryshuar projektin teknik". Gjithsesi, nëpërmjet këtyre ndryshimeve bëhet e mundur që jo domosdoshmërisht ai që bën ofertën e pakërkuar të fitojë edhe koncesionin. Kjo, pasi tashmë në garë përfshihen edhe operatorë të tjerë ekonomikë, që mund të sjellin një ofertë më të leverdisshme financiare për shtetin.

**TIRANË** - Prokuroria e Krimeve të Rënda ka kërkuar dje dënimin me 12 vjet burg për Saimir Çullhajn, i cili akuzohet për trafik armësh. Kërkesa e organit të akuzës vjen pas zgjatjes së hetimeve në gusht të këtij viti, ndërkohë që Çullhaji ndodhet nën masën e sigurisë "Arrest me burg". 33-vjeçari nga Shijaku u arrestua një vit më parë dhe konkretisht më 23 gusht në aeroportin e Rinasit, teksa po tentonte të trafikonte armë drejt



Saimir Çullhaji

## Trafik armësh me postë drejt Anglisë, prokuroria kërkon 12 vjet burg për 33-vjeçarin nga Shijaku

Anglisë. Gjatë kontrollit (skanimit), u gjetën dhe u sekuestruan 3 pako të kompanisë DHL, në të cilat ndodheshin tre armë zjarri automatik model 56, të çmontuara. Menjëherë pas sekuestrimit të armëve, blutë vënë në pranga Saimir Çullhajn, i dënuar më herët për trafik droge, ndërsa 47-vjeçari Neritan Farian nga Durrësi u shpall në kërkim.

Gjithashtu, në momentin e kapjes, Çullhaji u gjetën në trup dhe u sekuestrua një sasi prej 220 gr lëndë narkotike e llojit mariuanë "çokolatë". Sipas burimeve policore, gjurmët e shijaksit u gjetën në pakot DHL, ndërkohë që ky i fundit mohoi përfshirjen e tij në trafikun e armëve duke pretenduar se nuk e dinte çfarë kishte brenda në pako, dhe

se po niste një dërgesë tek miku i tij në Angli. "Një miku im me emrin Tani ma dha që ta postoja për në Britani. Unë nuk e di se çfarë kishte brenda. Bëra dorëzimin në postë dhe u largova me makinën e shokut tim. Kur u arrestova u njoftova edhe për atë që kishte brenda në pako", - pohoi para gjykatës, Saimir Çullhaji.

Trafiku ndërkombëtar i lëndëve narkotike, priten arrestime të bujshme

# Blokohet furgoni me 1.5 tonë kanabis në Qafë-Thanë, hetime në Elbasan e Fier

## Droga ishte fshehur në shasinë e mjetit, policia dhe FNSH ndalojnë 4 persona

ELBASAN

Një sasi e madhe kanabisi është sekuestruar dje nga policia e Elbasanit dhe Forcat e Ndërhjës së Shpejtë (FNSH) gjatë një operacioni antidrogë të zhvilluar në rrugën nacionale, në afërsi të Qafë-Thanës. Mësohet se lënda narkotike (pohohet të jetë rreth 1.5 tonë) u gjet në një furgon mallrash, i cili do të kalonte fillimisht në Maqedoni, por me destinacion përfundimtar Greqinë. Sipas burimeve policore, droga ishte fshehur në shasinë e automjetit. Ndërkohë, blutë kanë shoqëruar për në Drejtorinë e Policisë së Elbasanit disa persona, ndër ta dhe drejtuesi e furgonit. Sipas burimeve mjete është në pronësi të një firme fasonerie nga qyteti i Fierit dhe për llogari të hetimit do të merret në pyetje dhe pronari i këtij biznesi.

### OPERACIONI ANTIDROGË

Pak orë pas sekuestrimit të furgonit me kanabis në afërsi të pikës së kalimit kufitar të Qafë-Thanës janë zbardhur detaje të reja në lidhje me operacionin antidrogë. Mësohet se gjeografia e personave të përfshirë në trafikimin e drogës së kapur në një furgon të bardhë është shtrirë në qarqet e Elbasanit dhe të Fierit. Dyshohet se pjesë e këtij rrjeti është një organizatë kriminale me fuqi të madhe ekonomike. Burime pranë grupit hetimor sqaruan se furgoni, në të cilën u zbulua sasia prej afro 1.5 tonë lëndë narkotike e llojit kanabis sativa i përket një biznesi fasonerie në Fier. Sipas ekstraktit të QKR, biznesi është regjistruar nën emrin SILDA dhe në pronësi të biznesmenit Ilir Dauti. Firmë kjo që merret me prodhimin e këpucëve si dhe tregtimin dhe eksportimin e tyre jashtë vendit. Ndërkaq, pohohet se në momentin e bllokimit të furgonit të mallrave janë ndaluar katër persona si dhe janë identifikuar disa të tjerë të përfshirë në trafikun ndërkombëtar të drogës nga Shqipëria në Maqedoni dhe me destinacion Greqinë. Policia ka vijuar operacionin deri në orët e vona të mbrëmjes së djeshme me qëllim



Furgoni ku u gjet sasia e drogës

### TRAFIKU

Sipas burimeve policore, në momentin e bllokimit të furgonit të mallrave janë ndaluar katër persona si dhe janë identifikuar disa të tjerë të përfshirë në trafikun ndërkombëtar të drogës nga Shqipëria në Maqedoni dhe me destinacion Greqinë. Policia ka vijuar operacionin deri në orët e vona të mbrëmjes së djeshme me qëllim

cia ka vijuar operacionin deri në orët e vona të mbrëmjes së djeshme me qëllim arrestimin e tyre. Policia e Shtetit nuk ka dhënë detaje rreth këtij operacioni që pritet të finalizohet me arrestime të bujshme. Ndërsa, hetimi për rastin në fjalë është marrë nga Krimet e Rënda, pasi dyshohet se kemi të bëjmë me një rrjet trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike.

### RRJETI KRIMINAL

Pas sekuestrimit të furgonit me kanabis në afërsi të pikës të Qafë-Thanës, burime policore bënë me dije se gjeografia e personave të përfshirë në trafikimin e drogës së kapur në një furgon të bardhë është shtrirë në qarqet e Elbasanit dhe të Fierit. Dyshohet se pjesë e këtij rrjeti është një organizatë kriminale me fuqi të madhe ekonomike.

## Drogë nga Shqipëria në Itali, ekzekutohen 10 urdhër-arreste

**ITALI** - Policia italiane ka ekzekutuar disa urdhër-arreste për disa persona të përfshirë në trafikun e lëndëve narkotike të llojit heroinë dhe kokainë. Në orët e para të ditës së sotme autoritetet kanë ndaluar 10 persona, të cilët dyshohen si të përfshirë në trafik droge. Siç raportojnë mediat lokale në Itali, në mesin e të arrestuarve është edhe një shqiptar i njohur si Arjon Veliu, 37 vjeç. Pas përgjimeve telefonike dhe mbajtjes nën vëzhgim të grupit u arrit në gjetjen dhe sekuestrimin e 7 kg heroinë dhe 1 kg kokainë, e cila raportohet se vinte nga Shqipëria me qëllim kalimin në tregun italian.



Policia italiane ka sekuestruar, gjithashtu, një sasi të madhe parash kesh, të cilat i kishte përfutur grupi nga aktiviteti i paligjshëm i

drogës. Dyshohet se paratë e siguruar janë përdorur në blerjen e disa shtëpive në Itali në përpjekje për të fshehur aktivitetin e paligjshëm.

### SHKURT

**Interpol me drejtues të ri, Yang:**

**Mbështesim Shqipërinë**

**TIRANË** - Asambleja e Përgjithshme e Interpol ka zgjedhur Kim Jong Yang si president të ri. Drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu ka uruar kreun e Interpol për postin e ri, ndërsa Jong Yang ka shprehur gatishmërinë për të ndihmuar dhe fuqizuar më tej bashkëpunimin. "Asambleja e Përgjithshme zgjodhi përmes votimit, presidentin e ri të Interpol-it, z.Kim Jong Yang. Ai më parë ka mbajtur detyrën e zvpresidentit të Asamblesë. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Ardi Veliu, që mori pjesë në punimet e Asamblesë, uroi drejtuesin për detyrën e rëndësishme. Kim Jong Yang pasi e falënderoi Velinun i ka shprehur mbështetjen për policinë shqiptare, duke vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm, si dhe rëndësinë e forcimit të këtij bashkëpunimi", shkruan Policia e Shtetit në "Facebook".

**Çipa takon të dënuarit në burgun e Burrelit, transferohen 7**

**BURREL** - Mbrëmjen e 8 martës, në burgun e Burrelit janë transferuar 7 nga të burgosurit që ishin në grevë urie. Kështu bëhet e ditur nga burime të sigurta nga Burgu i Burrelit. Megjithatë nuk dihet se në cilin burg janë dërguar të dënuarit. Ndërkaq, dje rreth orës 15:00 ka mbërritur në burgun e sigurisë së lartë të Burrelit Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Stefan Çipa. Mësohet se ai ka takuar të burgosurit në të gjitha sektorët, si ato me dënim të përgjithshëm dhe ato me dënim nga 25 deri në 35 vite burg. 18 të dënuar në burgun e Burrelit u futën në grevë urie për shkak të kushteve të këqija me të cilat trajtohenin po dhe të tjerë i janë bashkuar nismës. Burgu i Burrelit është i mbopulluar, kapaciteti është 162 të burgosur, por ka më shumë se sa duhet. Avokatit të Popullit bëri me dije se prej të paktën tre vjetësh janë konstatuar kushtet e papërshtatshme të këtij institucioni, ndërsa është kërkuar edhe mbyllja e tij.

Prokuroria nis verifikimet, Ervin Salianji: E prisja, do vazhdoj denoncimet

# Letër nga burgu për deputetin demokrat: Do vritesh me snajper

*"Do të të qëllojë një ish-polic shkodranë, i liruar dy vite më parë nga qelia"*

TIRANË

Pak ditë më parë, në kulmin e shpërthimit të çështjes "Dako" dhe daljes së përgjimeve të prokurorisë për të pas operacionit "Vol-Vo 4", deputeti demokrat, Ervin Salianji ka marrë një letër kërcënuese në adresë të tij. "Do vritesh me snajper", shkruhej ndër të tjera në letrën e mbërritur në adresë të Salianjit më 31 tetor 2018 nga burgu i Fushë-Krujës, ku madje jepeshin edhe emrat e autorëve të supozuar. Letra ka mbërritur në adresën e Ervin Salianjit në selinë e PD-së nga një i burgosur i quajtur Agim, i dënuar me 24 vite burg për vrasje. Mësohet se ky i fundit i shkruante deputetit demokrat se do vritej me snajper nga një ish-punonjës policie, i quajtur Dorian Duli, 38 vjeç, me origjinë nga Parruca e Shkodrës, i cili ka qenë i dënuar; por është liruar nga qelia në 21 janar të vitit 2016. "Zoti Ervin, juve do qëlloheni me



Faksimile e letrës kërcënuese të deputetit demokrat, Ervin Salianji

snajper nga 38-vjeçari Dorian Duli, ish-punonjës policie me origjinë nga Parruca Shkodër, i liruar nga burgu më 21.01.2016. Ky person në bashkëpunim edhe me anëtarë të bandës së Lulzim Berisha... me porosi edhe të Vangjush Dako...", shkruhet mes të tjerash në letër. Më pas, Salianji ka bërë denoncim në Prokurorinë e Përgjithshme dhe për dijeni dhe Shërbimit Informativ Shtetëror. Ndër-

kaq, Prokuroria e Përgjithshme e ka kaluar çështjen tek Krimet e Rënda dhe po bëhen verifikimet për rastin. Në lidhje me rastin në fjalë ka reaguar deputeti i Partisë Demokratike. Në një prononcim për "News 24", Ervin Salianji tha se rasti po ndiqet nga institucionet dhe se e kishte parashikuar që mund të ndodhnin gjëra të tilla, por se do vazhdojë denoncimet.

## REAGIMI I DEPUTETIT

"Ju keni marrë sot info për këtë çështje, por unë kam kohë që kam dijeni dhe nuk e kam gjykuar si çështje publike. Madje, bëjra publike u jep pikë pikërisht këtyre formave të intimidimit apo intrigës që të ushtrohet presion nëpërmjet përdorimit të delikuentëve. Në dijeninë time, rasti po ndiqet nga institucionet. Personalisht të gjitha këto i kam parashikuar dhe nuk më bëjnë përshtypje, çfarëdo qoftë sajese e qeverisë apo përpjekje delikuentësh. Nuk më bën asnjë përshtypje dhe siç mund ta kenë ndjekur, kam vazhduar denoncimet e krimet edhe në majat më të larta të pushtetit", u shpreh deputeti i Partisë Demokratike.



## Arta Marku, urdhër vartësve: Hetim dhe konfiskim të pasurive të kriminelëve

**TIRANË** - Kryeprokurorja e Përkohshme, Arta Marku ka nxjerrë para dy ditëve një udhëzim për hetimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të personave që i kanë vendosur me veprimtari të paligjshme, trafik droge, organizata kriminale, korrupsion etj. Udhëzimi do të jetë në fuqi deri në ngritjen e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimet të organizuar. Mësohet se seksioni i posaçëm për hetimin pasuror do të ngrihet në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Ndërkaq, Arta Marku kërkon që prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore përmes burimeve ndryshme, të hapura ose jo, media, zyrat e prokurorive, Policia e Shtetit, Ministria e Drejtësisë, SHISH apo të tjera institucione, menjëherë, por jo më vonë se dy muaj nga hyrja në fuqi e udhëzimit të identifikojnë personat për të cilët ka hetime apo vendime të formës së prerë, shqiptarë apo të huaj me banim në Shqipëri. Pas marrjes së dokumentacionit, prokurorët e strukturës së posaçme, nën mbikëqyerjen e drejtuesit të Krimeve të Rënda duhet të vlerësojnë nisjen e hetimit pasuror: Nëse nga hetimi arrihet në përfundimin se duhet të vendoset sekuestro mbi pasurinë, atëherë prokurori i çështjes ia kalon strukturës së posaçme. Verifikimet për pasurinë do të kryhen në të gjitha institucionet, përfshirë edhe llogaritë bankare.

## "Kërkojmë përjashtimin e trupës gjyqësore"

Dosja "Hajdari", avokati i Izet Haxhisë: Procesi ligjor po cenohet

**TIRANË** - Ish-truproja e Sali Berishës, Izet Haxhia dhe avokati Bashkim Nikolli kanë kërkuar përjashtimin e trupës gjyqësore me anëtarë: Valdete Hoxha, Genti Shala, Astrit Haxhialushi, me arsyetimin se kjo trupë nuk mund të garantojë një proces të paanshëm. Avokati Bashkim Nikolli tha se ai bashkë me klientin e tij do të kërkojnë që treshja e përcaktuar të zëvendësohet me një trup gjyqësor nga Apeli i rretheve. Sipas avokatit, fakti që bashkëshortja e Azem Hajdarit punon në të njëjtin ambient me trupën gjyqësore tregon se procesi është i cenusshëm dhe nuk mund të vijohet me këtë metodë gjyqësore, sepse me ose pa qëllim gjyqtarët nuk mund të garantojnë proces të drejtë. "Po janë të njëjtat arsye që paraqiti edhe treshja e trupit gjyqësor. Arsyetja ishte e mbështetur në të njëjtin dispozitë ligjore, kur ka shakaq të rëndë-



sishme, cenohet procesi, edhe mund të kemi proces të njëanshëm. Fatmira Hajdari punon aty, kjo do ta cenonte të gjithë trupën gjyqësore, sepse nuk ka një muaj apo një vit që punon aty, por ka disa. Normalment që punojnë në të njëjtin ambient, duam apo nuk duam janë ndikime relative. Kemi raste shumë e thjeshta. Caktohen një treshje trupë nga Apeli i rretheve dhe të mos kemi kontestime, atëherë fillojmë gjyqin. Kur ka shakaq të rëndësishme që cenojnë procesin, aty nuk ke psegulmon. Të na lërë mundë-

inë të paraqiten prova dhe fakte, pastaj jemi në shina të rregullta për vijimin", tha avokati për "News 24". Ndërkaq, mësohet se dhe trupa gjyqësore ka kërkuar më parë dorëheqjen nga kjo çështje, pasi e konsiderojnë veten të njëanshëm në lidhje me kërkesën e bërë prej tij. Ndërsa, ende nuk është caktuar një datë se kur do të mblihdhet treshja gjyqësore. Izet Haxhia ka qenë truproja e ish-kryeministrit Sali Berisha, ndërsa akuzohet për vrasjen e ish-deputetit të Partisë Demokratike, Azem Hajdari.

**Tirana International Airport**  
 Nënë Tereza

### TENDER NOTIFICATION

**FOR CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I  
RECONSTRUCTION OF TAXIWAYS B, W AND W2  
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is requesting offers for reconstruction of TAXIWAYS B, W AND W2.

TIA is looking to contract a company to undertake this project that will consist of: demolition of existing pavement taxiway structures, soil removal and excavations, drainage works, full construction of taxiways, reconstruction of taxiways, airfield lighting and all required installation and connection works.

To participate in this process interested parties will need to retrieve the Invitation to Tender and Confidentially Commitment Document together with the respective forms, which can be retrieved at Tirana International Airport premises, Administration Building, Rinas, until 23 of November 2018.

Only to the companies that will submit the confidentiality commitment and it's forms will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the offer.

The set of tender documents will be delivered free of charge, in a CD, upon receipt of the above forms.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I"

The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k  
Administration Building  
Rinas, Tirana  
Albania**

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 20 December 2018.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:  
[ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com); [ivojka@tirana-airport.com](mailto:ivojka@tirana-airport.com); [apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com)

# STATUSI I MINATORIT PROTESTA



**DED MARKU**

### "Rritja sipas statusit"

"Gjithashtu, në statusin e minatorit parashikohet që ata që kanë mbi 10 vite vjetërsi në punë, për çdo një vit të marrin 2% shtesë të pagës bazë minimale kombëtare. Kërkesat tona janë minimale dhe presim miratimin e zbatimin e tyre të menjëhershëm. Punonjësit e minierave që do të përfitojnë nga ky status do të marrin një shtesë mbi pensionin bazë aktual, prej 96 mijë lekësh të vjetra për shkak të punës së vështirë dhe kontributeve të larta që kemi derdhur",-thotë Marku.



**ALI ÇAUSHI**

### "Na tradhtuan"

"Gjithë kjo vorbull e krijuar është brenda Ministrisë së Financave, dhe një rol të madh në gjithë këtë sorollatje kanë edhe tradhtarët mes radhëve tona si Fiqiri Xibri e Gëzim Kalaja. Fiqiri Xibri ndryshe shprehet mes nesh dhe ndryshe në bisedime me qeverinë, na shiti ne minatorëve dhe ka filluar të mbrojë ministrinë, sepse është blerë për të krijuar turbullira mes nesh. Shteti i ka ngritur themelet mbi votat tona, por kanë për të ngrënë këmbët e veta",-thekson Çausi për 'GSH'.



**GJERGJ MARKU**

### Protesta të premtën

"Kemi vendosur që të protestojmë sërish për miratimin e statusit të minatorit në 26 nëntor. Vlen të theksoj se këtë herë do të tregohemi të vendosur maksimalisht për të detyruar qeverinë që të miratojë statusin e minatorëve. Do të qëndrojmë deri në fund pasi nuk mban më ujë pilafi. Jemi lodhur, boll më me mashtrime, kemi 11 vjet që luftojmë. Pagesat e pensionit janë minimale dhe kërkojmë hakun tonë",-thotë Gjergj Marku.

Punonjësit e nëntokës: Të premtën protestë deri në plotësimin e kërkesave tona

# Pensionet e minatorëve, sa do të rriten pas miratimit të statusit

Hartuesi i draftit, Ded Marku: Shtesa sipas viteve të punës

Voltiza Duro

Ditën e nesërme, ish-punonjësit e nëntokës do të protestojnë sërish për miratimin e statusit të minatorit, i cili prej vitesh ende nuk ka kaluar në parlament. Drafti "Statusi i punonjësve të minierave nëntokë" parashikon që të përfitohet nga të gjithë ata që kanë punuar nëntokë për 10 vjet e gjysmë me kontribute e kanë 25 vite në total të siguruar si dhe kanë mbushur 55 vjeç.

**PENSIONI SIPAS STATUSIT**  
I pyetur nga 'Gazeta Shqiptare', një prej hartuesve të draftit, si dhe ish-punonjësi miniere, Ded Marku tregon se ata që do të përfitojnë nga ky status do të marrin një shtesë mbi pensionin bazë aktual, prej 96 mijë lekësh të vjetra për shkak të punës së vështirë dhe kontributeve të larta që kanë derdhur ndër vite. "Ne jemi diskriminuar nga ligji për pensionet e vitit 1993 ku u vendos tavan i pensionit dhe morëm pensione minimale. Dhe si pasojë minatorët marrin 130-140 mijë lekë të vjetra pension. Gjithashtu, në statusin e minatorit parashikohet që ata që kanë mbi 10 vite vjetërsi në punë, për çdo një vit të marrin 2% shtesë të pagës bazë minimale kombëtare. Kërkesat tona janë minimale dhe presim miratimin e zbatimin e tyre të menjëhershëm. Punonjësit e minierave që do të përfitojnë nga ky status do të marrin një shtesë mbi pensionin bazë aktual, prej 96 mijë lekësh të vjetra për shkak të punës së vështirë dhe kontributeve të larta që kemi derdhur",-thotë Marku për 'GSH'. Ky i fundit shton se prej kohësh kanë marrë vetëm premtime dhe nuk kanë parë asnjë akt konkret nga instancat përgjegjëse. "Ne jemi grupi



Foto Ilustruese

nismëtar i interesit për draftin e statusit të punonjësve të minierave nëntokë. Kemi 3 vjet që punojmë në mënyrë intensive për draftin e statusit të minatorit. Në 25 mars 2017 e kemi çuar për herë të parë në parlament këtë draft dhe premtimet ishin që do miratohej statusi para zgjedhjeve. Por pas zgjedhjeve na thanë që do kalonte në parlament në shtator të 2017-ës. Muajt ikën dhe ne e rifullmuam draftin dhe e dorëzuan te instancat përkatëse e deri te kryeministri. Një nen tjetër në draft thuhet që ish të përndjekurit politikë që kanë punuar nëntokë, 1 vit pune t'iu llogaritet 2 vjet. Këtë nen e mori Arben Ahmetaj dhe ka filluar zbatimin, pra vetëm këtë nen nga drafti",-thekson minator në pension. Ai shton se sorollatjet e pretekstet nga ana e ministrive vazh-

dojnë. "Disa herë të tjera kemi bërë rregullime ligjore në draft, por ministria sërish filloi nga lojërat e na kërkuan një muaj kohë që të nxirrinin efektin financiar. Madje kemi takuar edhe këshilltarin e kryeministrit, i cili na mashtroi me premtime. Tani drafti i statusit të minatorit ka ngelur peng në Ministrinë e Financave. Dy ditë më parë na thanë që po bëjnë pastrimin e skemës, ky është preteksti i radhës. Nuk presim dot se na kanë sorollatur shumë",-thekson Marku.

**PROTESTA**  
Minatorët do të vijojnë protestën e tyre të premtën e të revoltuar tregojnë se këtë herë nuk do të tërhiqen deri në përbushjen e kërkesave të tyre. "Pas shumë protestave, pas shumë takimesh me minis-

tra e zëvendësministra; kemi vendosur që të protestojmë sërish për miratimin e statusit të minatorit në 26 nëntor. Vlen të theksoj se këtë herë do të tregohemi të vendosur maksimalisht për të detyruar qeverinë (pas shumë mashtrimeve që na ka bërë) që të miratojë statusin e minatorëve. Jemi 27 persona që jemi lidhur besabesë derisa të marrim atë që na takon e do të qëndrojmë deri në fund pasi nuk mban më ujë pilafi. Jemi lodhur, boll më me mashtrime, kemi 11 vjet që luftojmë. Pagesat e pensionit janë minimale dhe kërkojmë hakun tonë",-thotë Gjergj Marku për 'Gazeta Shqiptare'. Ai më tej hedh akuzë edhe mbi sindikatat e minatorëve me pretendimin se kërret e tyre janë shitur për interesa personale. "Gjithë kjo sorollatje që na kanë krijuar gjithë

**PERFITIMET**  
"Ne jemi diskriminuar nga ligji për pensionet e vitit 1993 ku u vendos tavan i pensionit dhe morëm pensione minimale. Dhe si pasojë minatorët marrin 130-140 mijë lekë të vjetra pension. Gjithashtu, në statusin e minatorit parashikohet që ata që kanë mbi 10 vite vjetërsi në punë, për çdo një vit të marrin 2% shtesë të pagës bazë mini-male kombëtare."

këto vite, vijnë vetëm nga sindikatat që "gjasme" duan të mbrojnë të drejtat tona. Kryetarët e sindikatave janë shndërruar në ngatërrestarë të mëdhenj që na shiten për interesa personale. E madje kanë marrë përgjegjësinë e pastrimit të skemës. Kërkojmë miratimin e statusit një orë e më parë, deri në 26 nëntor nëse nuk marrim asnjë përgjigje do të fillojmë aksionin tonë që mund të shkojë deri në grevë urie deri sa të zgjidhet problemi",-thotë ish-punonjësi i nëntokës.

**PENSIONET E ULËTA**  
Minatorët më tej theksojnë për 'Gazeta Shqiptare' se masa e pensionit që marrin është qesharake krahasuar me vështirësinë e punës që kanë hasur nëntokë. "Unë jam një prej minatorëve të vjetër, e theksoj se jemi shtesa më e vuajtur

e shoqërisë shqiptare sepse kemi derdhur gjak e kemi bërë shumë sakrifica. Punonin me helme, me gaze, në kushte pune ekstreme e rrezikonim edhe jetën, por vështirësitë tona i dimë vetëm ne pasi këtyre nuk iu intereson. Minatorët e shkretë presin të marrin ndonjë lek shtesë me gjithë atë mund që kanë kontribut që kanë derdhur për vite me radhë gjatë punës në nëntokë. Ne kemi dhënë kontribut edhe në sindikatë e tani jemi rraskapitur shumë. Të marrë një minator 130 mijë lekë të vjetra pension është turp, turp i madh",-thotë Ali Çausi një tjetër minator në pension. Edhe ky i fundit hedh akuzë mbi kërret e sindikatave e i konsideron si tradhtarë të minatorëve. "Gjithë kjo vorbull e krijuar është brenda Ministrisë së Financave, dhe një rol të madh në gjithë këtë sorollatje kanë edhe tradhtarët mes radhëve tona si Fiqiri Xibri e Gëzim Kalaja. Fiqiri Xibri ndryshe shprehet mes nesh dhe ndryshe në bisedime me qeverinë. Fiqiri Xibri na shiti ne minatorëve dhe ka filluar të mbrojë ministrinë, sepse është blerë për të krijuar turbullira mes nesh. Kemi 3 vjet që po breshim derë më derë e zyrë më zyrë për miratimin e statusit të minatorit. Shteti i ka ngritur themelet mbi votat tona, por kanë për të ngrënë këmbët e veta. I bëj thirrje Fiqiri Xibrit të kthehet në vendin ku ka qenë e mos të shesë minatorët e tjerë",-thekson Çausi për 'GSH'.



Ministrja e Arsimit: Buxheti për 2019, 39 miliardë lekë. Rritje deri në 7% të pagave

# Rritja e pagave, mësuesit: Premtim i pa mbajtur nga Lindita Nikolla

"Kërkesat, deri më tani nuk kemi marrë asnjë lek shtesë"

Voltiza Duro

Ditën e djeshme, ministrja e Arsimit, Sportit e Rinisë Lindita Nikolla ka prezantuar buxhetin e vënë në dispozicion për MASR gjatë vitit 2019. Sipas saj, brenda buxhetit mbi 39 miliardë lekë, do të përfshihet edhe rritja e pagave për mësuesit deri në 7% me një fond prej 1.5 miliardë lekë. "Buxheti i MASR për vitin 2019 është mbi 39 miliardë lekë. Buxheti mundëson rritjen e pagave për të gjithë mësuesit me 7%. 1.5 miliardë lekë për rritjen e pagave. Sot kemi 700 mësues ndihmës nga një shërbim i munguar në 2013, por me buxhetin e 2019 do të kemi 1 mijë mësues ndihmës. Do të dhjetëfishojmë oficerët e sigurisë në shkollat për 2019", tha Nikolla. Kjo e fundit më tej shtoi se projekti "Bëjmë detyrat e shtëpisë" do të shtrihet në 90 shkollat të tjera dhe theksoi se buxheti do të jetë më së shumti për tekstet falas. "Bëjmë detyrat e shtëpisë, në 2019 e shtrijmë në 90 shkollat të tjera. Ne jemi të vendosur për të ecur në rrugën e reformave në arsim. Ky do të jetë buxheti i teksteve falas. Nga klasa e parë në të 5 falas dhe kategoritë në nevojë për 2019. Do të ketë 75 objekte të reja shkollore, terrene sportive e laboratorë. Mbjamë premtimin për sigurimin e 12 muajve paga për pedagogët. Por do të kryejmë inspektime se sa respektohet raporti trup administrativ- nxënës", theksoi ministrja. Ajo më tej tha se akuzat për rritje tarifash nga studentët janë të pavërteta. "Akuzat për rritje tarifash janë të pavërteta e këtë mund ta konfirmojnë rektorët këtu. Tarifa mesatare e studimeve është 26 314 lekë. 20 mln lekë për nxënësit ekselentë në mësuesi. Rritje të



**KËRKESAT E MËSUESVE DREJTUAR KRYEMINISTRISË DHE MASR:**

- rritjen e pagës deri në 40% sipas premtimit në fushatë.
- indeksimin e inflacionit për çdo vit -shpërblimin e fundvittit (5 vite plus 2018)
- një laptop për çdo mësues, në shërbim të cilësisë, sikur shtetet fqinje si Maqedonia.
- kushte më të mira punë, në biblioteka, laboratorë shkencash, laboratorë informatike, palestra sporti
- zbatimin e VKM shkurt 2018, mbi pagesën e një vakti ushqim deri në 3 mijë lek/ditë pune.
- investim në mensa shkollore për nismën detyrat në shkollë, me qëllim ushqyerje të shëndetshme.
- libra falas për arsimin e detyruar 1-9 dhe uljen e çmimit të teksteve për klasat 10,11,12.
- pagesën e orëve mbi normë
- transportin falas

mbështetjes ndaj ekselentëve. Sot nuk mundet të regjistrohesh në disa universitetet dhe nuk mund të doktorohesh pa qenë në universitet", u shpreh Ni-

kolla.  
**REAGIMI I MËSUESVE**  
Mësuesit theksojnë për 'Gazeta Shqiptare' se rritja e pagave për këtë kategori vazhdon të jetë një premtim i pa mbajtur nga ana e Ministrisë së Arsimit. "Ne kërkojmë rritjen e pagës deri në 40% sipas premtimit në fushatë, deri më tani nuk kemi marrë asnjë shtesë për rritjen e pagës së premtuar. Për 2019 buxheti i arsimit do të rritet me 1 miliardë më tepër duke kaluar nga 38 në 39 miliardë (2,6% më tepër). Kjo rritje nuk është në koherencë me rritjen ekonomike të vendit që për 2019 presupozohet të jetë 4,2%. E them këtë pasi arsimi është shtylla primare ku mbështetet e ardhmja e një vendi. Te ne harkohet për arsimin rreth 2,5% e GDP-së, ndërsa mesatarja e vendeve të BE-së është 4,9% e GDP-së. Çdo rritje rroge entuziazmon mësuesit megjithatë nuk duhet harruar që në tre vitet e fundit nuk kemi pasur indeksim të pagave. Rritja e inflacionit në këto tre vite ka qenë pak më e lartë se 5%. Në të tilla kushte mund të them se rritja reale e pagës në këto tre vite përfshirë këtu edhe rritjen e përfolur me 5% i bie që të jetë negative", thekson sindikata e arsimit të Shqipërisë në emër të mësuesve për 'GSH'. Gjithashtu, sot "Gazeta Shqiptare" zbardh edhe disa prej kërkesave kryesore të mësuesve që do t'i përcillen Ministrisë së Arsimit

**MINISTRJA**  
**LINDITA NIKOLLA**  
"Buxheti i MASR për vitin 2019 është mbi 39 miliard lekë. Buxheti mundëson rritjen e pagave për të gjithë mësuesit me 7%. 1.5 miliard lekë për rritjen e pagave. Sot kemi 700 mësues ndihmës nga një shërbim i munguar në 2013, por me buxhetin e 2019 do të kemi 1 mijë mësues ndihmës. Do të dhjetëfishojmë oficerët e sigurisë në shkollat për 2019", -tha Nikolla.



dhe kryeministrin të Shqipërisë. Mësuesit do të kërkojnë rritjen e pagës deri në 40% sipas premtimit në fushatë; indeksimin e inflacionit për çdo vit; shpërblimin e fundvittit (5 vite plus 2018); një laptop për çdo mësues, në shërbim të cilësisë, sikur shtetet fqinje si Maqedonia; kushte më të mira punë, në biblioteka, laboratorë shkencash, laboratorë informatike, palestra sporti.

**SINDIKATA**  
**RITJEA E PAGËS, NEGATIVE**  
"Ne kërkojmë rritjen e pagës deri në 40% sipas premtimit në fushatë, deri më tani nuk kemi marrë asnjë shtesë për rritjen e pagës së premtuar. Për 2019 buxheti i arsimit do të rritet me 1 miliardë më tepër duke kaluar nga 38 në 39 miliardë (2,6% më tepër). Në të tilla kushte rritja reale e pagës në këto tre vite i bie që të jetë negative", - thekson sindikata e arsimit të Shqipërisë.



Gjithashtu, kjo kategori do të kërkojë edhe zbatimin e VKM-së së shkurtit 2018, mbi pagesën e një vakti ushqim deri në 3 mijë lek/ditë pune; investim në mensa shkollore për nismën detyrat në shkollë, me qëllim ushqyerje të shëndetshme; libra falas për arsimin e detyruar nga klasa 1-9 dhe uljen e çmimit të teksteve për klasat 10,11,12; pagesën e orëve mbi normë; si dhe transportin falas.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR SHOQERUAR ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje makine shkaterrimi monedhash metalike per nevojat e Bankes se Shqiperise"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar shoqeruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 11,775,400 Lekë ose 93,300 Euro".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halliri", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktmëshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfuttesa: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje makine shkaterrimi monedhash metalike per nevojat e Bankes se Shqiperise"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 27 Dhjetor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

United Nations Development Programme

**TENDER ANNOUNCEMENT**

Subject: RFP - "Design and implement a communication campaign on public service reform: Citizen Charter"

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked UNDP Procurement Notices 51722 - RFP - "Design and implement a communication campaign on public service reform: Citizen Charter"

For more details please refer to the link below:  
[http://procurement-notices.undp.org/view\\_notice.cfm?notice\\_id=51722](http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=51722)

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than December 03, 2018, 15:00 pm.

Address for communications:  
Email: [procurement.al@undp.org](mailto:procurement.al@undp.org)  
Or  
Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2<sup>nd</sup> floor

## KUJTIMET

# BASHKIM ZENELI:

## Kur Inva Mula erdhi në Athinë, shteti shqiptar nuk më lajmëroi

"Miqësi e trazuar" titullohet libri i Bashkim Zenelit. Në të, vjen Greqia në kujtimet e ambasadorit ndërsa parathënia është e Henri Çilit. Pjesë nga libri i që do dalë së shpejti nga UET PRESS nën botohen sot në "GSH" me miratimin e autorit. Ngjarja e parë për të cilin ai flet është koncerti i sopranos Inva Mula në Athinë më 2003.

Vëren se teksta shtypi i bënte jehonë, vetë ambasada nuk ishte vënë në dijeni dhe se kjo për të, ishte në dëm të diplomacisë kulturore.

Nga Bashkim Zeneli

### DIVA INVA MULA NGRE PESHË ATHINËN.

Më 1 tetor 2003, jo vetëm shqiptarët në Athinë, por edhe grekët dhe të huajt në kryeqytetin helen do të përjetonin një ngjarje të madhe kulturore dhe artistike: Inva Mula, sopranoja shqiptare me famë botërore, do të këndonte në Teatrin Antik Herodion të Athinës.

Shtypi kishte disa ditë që i bënte jehonë kësaj ngjarjeje dhe vetëm kjo na bëri që, meqë nuk kishim dijeni si ambasada, të kontaktonim me organizatorët për çdo detaj. Do të kërkonim të na rezervoheshin dhe bileta për diplomatë të huaj, por edhe për bashkatdhetarë të fushës së artit, kulturës e muzikës. Nga Tirana nuk kishim asnjë njoftim dhe kjo fliste shumë se si dhe sa punohej për atë që i vinin emër të madh: diplomacia kulturore!...

Ato ditë në Athinë ishte për vizitë zyrtare edhe zv.kryeministrja jonë, zj. Ermelinda Meksi.


... Teatri Herodion në Akropol ishte një nga mrekullitë e antikitetit. Që nga viti 1955 aty do të zhvillohej, çdo vit, festivali ndërkomëtar i Athinës, një mrekulli e jetës artistike dhe kulturore të kryeqytetit. Një mesazh shumë i fuqishëm për paqe, liri, harmoni, bashkëjetesë e bashkëpunim midis popujve. Një mesazh që dukej se vinte nga Athina antike që drejtohej nga i famshmi Perikli.

Do të na kujtohej thënia e famshme e Issak Newton: "Popujt përpiqen të ndërtojnë shumë mure, por jo sa duhet ura".

Dhe Athina, kjo e sotmja, e shekullit të 21, në Herodion, por jo vetëm aty, po përcillte mesazhin se punonte për të ndërtuar ura!

Teatri antik, aty ku do të lindte në

"Miqësi e trazuar", ambasadori boton kujtimet e kohës kur ishte diplomat në Greqi



“  
Inva Mula dhe Marios Frangulis, para pak kohësh, kishin dhënë një koncert shumë të suksesshëm në teatrin e bukur të Butrintit, në Sarandë.

Athinë që në shekullin e 8 p. K. dhe gradualisht do të përhapej në të gjithë Greqinë. Në atë kohë sundonte kulti i Dionisit. Vallëzimi,

kënga, recitimi dhe mimika përbënin teatrin kor që këndonte duke lëvizur në skenë. Në atë kohë artistët mbanin edhe maska druri ose lëkure. Në vitin 534 p. K., poeti Thespris praktikoi i pari edhe dialogun në skenë. U sollën karaktere të ndryshëm. Skenat u ndërtuan që të kishte akustikë për dialoget apo deklaratimet e aktoreve. Dhe ky lloj ndërtimi, kjo akustikë plot jehonë të pastër, ishte një zbulim tjetër i madh i burrave të shquar të antikitetit.

Në fillim të ndërtimit të tyre, vendet e uljes ishin të ndërtuara me stola druri e, më pas, rreth vitit 500 p. K., nisën të ndërtohen vendet me radhë guri të pastra e të lëmuara. Ishin të njohur për kohën edhe teatrot Festos në Kretë, teatri i Filipit në Maqedoni, teatri i Dodonës me 18 mijë vende, në Epirj etj., etj.

Artistja jonë e madhe Inva Mula do të këndonte së bashku me tenorin shumë të njohur e të dashur për grekët Marios Frangulis. Por do të këndohej edhe dueti i përbërë nga soprano Kerin Ingeleland dhe Rebeka Najt. Të dyja këto artiste të mëdha ishin të njohura edhe nga interpretimi i tyre i mrekullueshëm para finales së kupës së Anglisë, në vitin 2001 dhe para finales së Champion League, po në atë vit, në Milano. Në piano do të shoqëronte artisti i njohur spanjoll Edelmiro Arnaltes.

Të gjithë ishin artistë të mëdhenj, por padyshim më vinte shumë mirë që faqet e para të gazetave ato ditë do t'i përqendroheshin Inva Mulës, ashtu si edhe lajmet kryesore në kanalet televizive. Kjo na bënte krenarë dhe mendja më shkonte vazhdimisht: Si mundet që nuk na njoftoi askush nga Tirana për ardhjen e saj në Athinë?!

Inva Mula dhe Marios Frangulis, para pak kohësh, kishin dhënë një koncert shumë të suksesshëm në teatrin e bukur të Butrintit, në Sarandë.

### TIRANA

Të gjithë ishin artistë të mëdhenj, por padyshim më vinte shumë mirë që faqet e para të gazetave ato ditë do t'i përqendroheshin Inva Mulës, ashtu si edhe lajmet kryesore në kanalet televizive. Kjo na bënte krenarë dhe mendja më shkonte vazhdimisht: Si mundet që nuk na njoftoi askush nga Tirana për ardhjen e saj në Athinë?!

Tani i priste Athina. Në këtë teatër, plot 5000 vendesh, kishin dhënë koncerte mjeshtër dhe solistë me famë botërore, orkestra me emër, me muzikë paraklasike, klasike, romantike dhe moderne.

Mjeshtër të mëdhenj, që nga Ausermer dhe Mitropoulos, tek Abbado dhe Berutcin, nga Pablo Casias dhe Rostropovich, nga Oistrakh e Rubinstein, kishin qënë të privilegjuarit për t'u njohur në këtë skenë të teatrit antik.

Balete me emër të madh në botë si ai i Nurejevit të famshëm, të Fonteyn, Vasiliev Bejart, Martha Graham, Robbins, baleti i njohur i Harlemit, balete shtetërore që nga i jashtëzakonshmi Bolshoi deri tek ai i Holandës, i Nju Jorkut, i Monte Carlos dhe i Paris Opera Ballet, kishin bërë që të "të dridhen" gurët e lashtë të



skenës.

Aty ku mijëra vite më parë janë shfaqur tragjeditë antike dhe komeditë, sidomos të Aristofanit, e më pas edhe drama greke dhe europiane, të teatrit modern Europian, nuk do të mungonin të këndonin këngëtarët me famë botërore si Sinatra, Cabaille, Carreras, Domingo, Pavaroti etj.

... Dhe tani ishte radha e Inva Mulës. Athinasit e dinin shumë mirë se kush ngjitet në atë skenë, ishte pa dyshim i famshëm. Ajo skenë ishte për ta!

Nën këmbët e Akropolit legjendar, teatri do të merrte një zhvillim të jashtëzakonshëm në kohën kur sundonte Perikliu i madh. Ai e konsideronte teatrin dhe skenën e tij si një zonë të shenjtë. Teatri nuk ishte vetëm teatër. Mbi të gjitha ai ishte një institucion demokratik që nuk përjashtonte askënd. Një institucion masiv i mbledhjeve dhe i marrjes së vendimeve të rëndësishme. Edhe vetë teatri romik u kthye në institucion që nuk përjashtonte askënd. "Teatri më i madh dhe më i vjetër në Europë, i pambulluar, u ndërta në fund të shekullit të 5-të p. K., në pjesën juglindore të Akropolit. Ai kishte 27000 vende". Perikliu, ky burrë i madh shteti dhe kryetar i shtetit të Atikës, drejtoi për plot 14 vjet (443-429 p. K.). Ai njihet tashmë në mbarë botën si strategu dhe burri i parë Europian i shtetit.

Ai u kujdes shumë për ndërtimin e një qytet-shteti modern për kohën, por në mënyrë të veçantë u kujdes për artin, kulturën, letërsinë dhe filozofinë.

Për herë të parë shohim punimet në skulpturë me ndërtimin e trupit të njeriut nga mjeshtëri i famshëm Fidia. Lulëzon arkitektura e mjeshtërit Iktinos. Marrin një zhvillim të madh teatri dhe skena me kryemjeshtër Euripidi, Sofokliu dhe Eskili. Aty ka shkëlqyer Eskili. Aty është interpretuar edhe Sofokliu me Edipin Mbret, me Edipin në Kolonë, me Antigonen, me Ajaksin, Elektrën, Filokletin,



Trakinëset etj. (Këto vepra janë përkthyer nga i madhi Gjon Shllaku dhe janë botuar në citin 1995 nga shtëpia botuese "Faik Konica" nën kujdesin e Ilirian Zhupës.)

Dalin piktorë të mëdhenj dhe skulptorë të famshëm si Timotheas, Skopas, Bryaxis që prodhojnë portrete të mrekullueshme dhe punime të rralla në mermer. Do të lind dhe do të rritet aty mjeshtri i madh, piktori Lyssip, që do të pikturonte më shumë e më mirë se kushdo tjetër Aleksandrin e Madh.

Me vëmendjen e jashtëzakonshme dhe pasionin e madh të Perikliut, do të rindërtohej, pas disa dëmtimeve, teatri nën këmbët e Akropolit legjendar. Ai u bë shembull i artit, kulturës dhe sportit grek.

Është koha kur Turkididi, shok i kohës së Perikliut, nis dhe e sheh me një sy më të thellë historinë, mbi bazën e të dhënave dhe fakteve shkencore të kohës.

(Do të ishte Herodoti, babai i të shkruarit të historisë, i pari dhe më i madhi, që në këtë fushë do t'u ndriçonte rrugën pasardhësve... Historia e Athinës fillon rreth 5000 vjet më parë, atëherë kur grekët e lashtë në malin Laile ndëruan Akropolin e lashtë dhe themeluan "qytetin e lartë").

Me kalimin e kohës, qyteti nis e shtrihet, duke u zgjeruar në këmbët e malit (kodrës) - grekëve u pëlqen ta quajnë mal, - dhe mori emrin Athinë, për nder të perëndeshës Athina.

Gjatë shekullit të 5-të p. K. qyteti nisi të kthehej në një qendër të madhe kulturore, ekonomike, politike e shoqërore të Greqisë. Aty erdhën brez pas brezi shumë filozofë e mendimtarë, oratorë e poetë, dramaturg, historianë, arkitektë, mjeshtrë të mëdhenj të arkitekturës. Vepra e tyre rreth 3000 vjet më parë, jo vetëm e ka influencuar pjesën tjetër të botës, por, pse jo, edhe sot "lë pa mend" këdo për kohët e arta të Athinës dhe athinasve.

Në vitet 480 p. K., në betejat me ushtrinë e madhe perse, do të dëmtonte shumë Akropoli. Dhe vetëm pak më vonë, kur pushtetin e mori Perikliu, Akropoli, por edhe dëmtime të tjera të Athinës, do të rindërtohej.

Kohës së Perikliut i përket ndërtimi i veprave të mëdha e monumentale, sheshet, tregjet, rrugët, restorantet, tempujt, teatri madhështor të Dionisit etj.

Është periudha e ndritur e sundimit të Perikliut kur, për

në një shtet territorial me kufi të përcaktuar.

Në Athinë jetonte e jepte mësim filozofi Anaksagoras, i cili ishte i pari që foli për "shpirtin e materies". Athinës i përkisnin Dionisi, Sofokliu, Euripidi.

Athinës i përkiste plastika e famshme e Fidias në art. Athinës i përkiste teatri dhe dramati e fuqishme. Athinës i përkiste Sokrati, që hapi një epokë të re filozofike! Athinës i përkiste Platoni (427-347), nxënësi i Sokratit. Asaj



Inva Mula

herë të parë në histori, mbrohet me ligj stili i jetës private, mbrohet liria dhe barazia e qytetarëve si diçka e "lartë". Athina ishte qyteti i parë në botë, demokracia e parë në botë, ku pushtetin e kishte plenumi i qytetarëve të lirë. Aristoteli do t'i përcaktonte njerëzit si "zoon politikon", si thelb natyre, karakter politik. Ai ndryshon nga kafshët dhe nga zoti, sepse, sipas tij, ai jeton në "polis", një bashkësi shtetërore,

## SOPRANOJA

Do të kërkonim të na rezervoheshin dhe bileta për diplomatë të huaj, por edhe për bashkatdhetarë të fushës së artit, kulturës e muzikës. Nga Tirana nuk kishim asnjë njoftim dhe kjo fliste shumë se si dhe sa punohej për atë që i vinin emër të madh: diplomacia kulturore

## TEATRI

Në atë teatër ku prisnim të këndonte Inva Mula, 2400 vjet më parë, shtetari i famshëm Perikliu, pati mbajtur një fjalim të jashtëzakonshëm para athinasve. Ai kërkoi që të përsosej Kushtetuta dhe të hiqej dorë nga fjalët e përgjithshme dhe të kishte formulime rigorozisht të zbatueshme. Ai do të bënte paraprakisht "konsultime" me specialistët më të mirë të fushës.

i përkiste Aristoteli (384-322), babai i idealizmit, që studion pa pushim veprën e Platonit dhe punon për të vendosur mbi baza shkencore të kohës metodologjinë e mësimt.

Mbi teatrin e famshëm, në Akropol, Fidias, mik i sundimtarit epokal, Perikliut, vendosi në lartësinë 160 m procesionin për nder të perëndisë së qytetit, Athinasë së bukur...

Ai teatër, teatri Herodion i Athinës, ku do të këndonte artistja jonë e madhe Inva Mula, kish të një histori të pandarë nga qyteti i Athinës. U ndërtua aq madhështor sepse madhështore dhe e vrullshme, plot shkëlqim e rrezatim, plot lavdi ishte Athina dhe jeta në të.

Qytet-shteti i Athinës, në kohën e mendimtarit të tij, Perikliut, që bëri për qytetin më shumë se kushdo tjetër, kishte 350 mijë banorë (2500 vjet më parë).

115 mijë ishin shkollëvër që shiteshin e bliheshin, 40-50 mijë ishin qytetarë të Athinës e që quheshin "popull". Ata kishin të drejtë të zgjidheshin e të zgjidhnin në Kuvendin e Popullit (Eklezia). Kuvendi mblidhej disa herë në muaj; ata që ishin në qytet, me numrin më të madh, mblidheshin edhe më shpesh. Parti nuk kish-te...

Çdo qytetar kishte të drejtën aktive të zgjedhjes. Secili kishte të drejtë të propozonte e të ngrihej për të mbrojtur apo kundërshtuar një ligj. Me dorën e ngritur nga shumica, ligji hynte në fuqi.

Kuvendi zgjidhte 10 strategët që për një vit duhet të udhëhiqnin shtabin madhor. Në situata të caktuara të trazirave të brendshme, kuvendi kishte të drejtë të zgjaste mbi një vit këtë mandat.

Gratë, në kohën e Perikliut, ishin të përjashtuara nga jeta publike dhe politike. Ideali i familjes ishte i mrekullueshëm: të edukonte njerëz të mirë (Kalos Kagathos), të bukur, me sjellje të shëndosha e me fizik të përkryer atleti.

Në shkolla mësohej leximi, shkrimi dhe aritmetika, por edhe këngët dhe kërcimi. Në shkolla ishte i detyrueshëm të mësoheshin instrumente muzikore. Ajo që mësohej me shumë vullnet nëpër shkolla, por edhe me mësuës privat, ishte Eposi i Homerit. Edhe poetët e mëdhenj në themel kishin dy Eposet e Homerit, me njeriun në qendër; më dashurinë për atdheun, me krenarinë për Akilin...

Poetja e dashurisë, oratoria Safo, ishte gjithashtu në themel

të mësimt në shkollë.

Nxënësit merrnin edhe mësim politik, sidomos për të drejtat dhe detyrat. Përgatitja fizike në gjimnaz ishte ndër detyrat më të rëndësishme. Mësohej ecja, hedhja, kërcimi së gjati dhe së larti, loja me top, mundja, dy-luftimet etj.

Arsimi ishte vetëm për djemtë, vajzat rrinin në shtëpi. Të gjitha institutet e arsimit ishin private. Nga mosha 7-14 vjeç fëmijët ndiqnin shkollat apo mësuësit privatë në shtëpi në lexim, shkrim, aritmetikë, këngë dhe instrumente muzikore. Por rëndësi e veçantë u kushtohej edhe punimeve të dorës (Banausia). Në moshën 15 vjeç shkohej në gjimnaz (gymnos), ku përveç disiplinave të tjera, bëhej edhe edukimi në arte dhe në shkencë. Më pas funksionuan edhe shkollat e filozofisë, astronomisë, fizikës dhe matematikës së lartë. Në gjimnaz ushtrohej rregullisht edhe ecja sportive, që ishte shumë më e vjetër, që në vitin 776 p. K., në distancën 192 m. Por ushtrohej edhe hedhja e diskut, në shekullin e 5-të p. K., pak kohë para sundimit të Perikliut (Një statujë me famë botërore, me atletin që hedh diskut, ndodhet në Muzeun Kombëtar në Napoli). Ushtrohej edhe 5-garëshi. Në periudhën e Perikliut 2 fjalë ishin magjike, ishin ideali i edukimit: kalokagathia (të jesh i bukur, i mirë) dhe agon (duel, dyluftim).

Shumica e garave shoqërohej me muzikë. Në përgatitjen masive fizike të rinisë shquhej sidomos Sparta.

Në periudhën e sundimit të tij, Perikliu i dha një nxitje të madhe zhvillimit të muzikës. Ai do të organizonte në mënyrë të rregullt koncerte në teatrin e Akropolit, deri edhe konkurse të muzikës.

... Muzika greke u zhvillua nga dy rrënjë: feniko-aziatike e vogël dhe kretio-mikenase, si traditë. Këngëtari i famshëm i këngëve heroike, në kohën e Homerit, ishte Aoidos. Ndërsa me Terpandrin nga ishulli i Lesbos, në vitin 675 p. K., fillon historia e pasur e muzikës.

Parimi kryesor i muzikës greke ishte dakordësia me etikën, si parimi i Platonit dhe i vlerave të këtij kombinimi. Ndërsa Pitagora përcaktoi funksionin e muzikës si "zë i shpirtit në harmoni me gjithësinë". Instrumentet frymore i përkisnin botës dionike. Më vonë do të hynte edhe kitara, lyra (lira) etj.

Në atë teatër ku prisnim të këndonte Inva Mula, 2400 vjet më parë, shtetari i famshëm Perikliu, pati mbajtur një fjalim të jashtëzakonshëm para athinasve. Ai kërkoi që të përsosej kushtetuta dhe të hiqej dorë nga fjalët e përgjithshme dhe të kishte formulime rigorozisht të zbatueshme. Ai do të bënte paraprakisht "konsultime" me specialistët më të mirë të fushës.

Në atë kohë, në Greqi kishte 10 gjykata me 6000 gjyqtarë, që ndërrohej çdo vit nga lista e qytetarëve. Prokurorë nuk kish-te por kishte avokatë mbrojtës, që mbanin kostot e procesit gjykyes. Dhe flasin për shekullin e 5-të p. K., në një lulezim të pasqo të Athinës, në të gjitha fushat.

(Vijon nesër)

## PROZA LETRARE MID'HAT FRASHERI

Historiani i njohur Uran Butka ka përmbledhur disa pjesë të zgjedhura të Mid'hat Frashërit me rastin e kthimit të eshtrave në atdhe

# "Më pyete pse të dua dhe unë qesha", proza letrare e filozofike e Lumos Skëndos

"Shohim sot kafenetë dhe selamllëket plot pluhur, hi dhe baltë, mbushur me njerëz përtacë, që shkojnë të njëzet e katër orët e ditës me politikë"

Mid'hat Frashëri  
(Lumo Skëndo)

**P**o botojmë disa proza letrare, meditative e filozofike të Mid'hat Frashërit (Lumo Skëndo) të nxjerra nga veprat e tij të zgjedhura botuar nga Instituti i Studimeve Historike "Lumo Skëndo" në tri vëllime, me rastin e 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit, kryetar i të cilit ishte Mid'hat Frashëri dhe kthimit në atdhe të eshtrave të këtij personaliteti të madh të historisë, politikës dhe kulturës shqiptare.

### PROZA POETIKE:


Më pyete pse të dua dhe unë qesha.

Qesha, ama tani po mendohem dhe them: Pse të dua? Të dua për atë të qeshur të bukur, kur të shkëlqen syr' i kthjellët nën ballë të qëruar; të dua për ato leshra ku është pëshënjellë gjithë thellësi e natës, dhe për atë vështrim ku këndohet gjithë gaz' i ditës, për atë vështrim q'është si një yll i lumturisë; të dua, se kur flet, ay zë më zgjon në zemrën time gjithë zërat e fshehtë të shpirtit; të dua se pranë teje, e ndiej veten time të madh dhe të fortë, se në dashurinë tënde shoh zbardhëllimin e jetës.

Po të dua se, tekdo, me gëzim të fatbardhësisë, a në t'errët të helmët, se në qeshje të mëngjesit, në tym të të mugëtit, se në ngjyrë të lules a në përkëdhelje të veriut, tekdo, o e dashura ime, ty të gjej dhe ty të shoh; të dua se edhe kur zbres në thellësi të shpirtit dhe në fund të zemrës, edhe atje thellë të gjej.

Ah, po bie shi prapë Eja, mike, se po bie shi! Më duket sikur po qan qielli, sikur po derdh lotë të hollë. Edhe zemra ime sot po qan. Jam vetëm; lotët e qiellit rrjedhin jashtë qelqevet dhe po ndiej të ftohtë brenda në zemër.

E mban mend, mike, kur ishim bashkë sa shum' e donim shiun? E mban mend gazin që ndjenim afër dritares, kur binin pikat e mëdha të shiut? Ti i prisnjë



ato ditë, se e dinje që më pëlqenin; i prisnje ato ditë, më prisnje mua.

Ahere, kur bota mbytej me lotë, ne ishim të gëzuar; ahere, kur bota mbulohej me ujë të ftohtë, ne kishim të nxehtë në zemër.

Po tani, nga kjo gjysm'odë shikoj pikat, që po kullojnë dhe po mërdhi.

Afrëdita e Milo-s Fidia më s'pat prehje. Gjumi më s'ia çlodhi sytë. Ngrënies më nuk i gjeti shije. Një ethe çdo ditë i digte dejtë.

Përpara shkëmbit të mermerit si shkumb' e bardhë, Fidia po punon dhe po mejtohet. Muskujt e tij po i xhonglohen nën cekanin e rëndë, një djersë etesh po i kullon nga ballët, një zjarr po i ndriton sytë.

Edhe më s'pat prehje. Çdo ditë nga shkëmbi po dilte një formë e re. Punoi, punoi, akoma, me zjarrin e shenjtë. Kërkonte bukurinë, gjithnjë të ëndërruar, kurrë të parë.

Kur u mbarua vepra, Fidia e shikoi me syt' e nxehtë, me ata sy që s'ishin lodhur kurrë. E shikoi akoma, edhe një herë dhe i mbylli sytë, se guri i ftohtë iu duk i gjallë, me guri i shpirt, me një frymë, që s'i kish pandehur.

I lumtur Fidia, m'i lumtur se Hyji!

Se mendja jote polli bukurinë e pavdekur, gruan, gjith-

një të dëshiruar, kurrë të gjetur.

Lermë, grua! Lermë, grua, lermë të t'admiroj trupin tënd të bërë prej drite dhe shpirti! Dua të ndiej gjakun tënd të rrjedhë nën përkëdheljen time; të shikoj dhe të mos ngjijem me këtë kraharor të bardhë. Fryje gjirin, ndehi krahtë, se je tërë bukur dhe ke fuqinë e përjetshme, atë fuqi që rremben mendjen dhe zemrën.

Ndehi krahtë, fryje gjirin dhe zgjatmë buzë! Por, oh, më tepër se të gjitha akoma, shikomë në sy, se dua të ndiej atë zjarr; atë dritë, që ndez gjakun, atë vetëtimë që çel errësirën; dua që shpirti im të rrijë i qepur tek i tyti dhe trupi yt të më rrembejë.

Lermë të të shikoj e të t'admiroj, se dua që rrojta dhe qenia ime të kridhet tek shpirti dhe zemra jote, dua që të humbas fuqinë time në ata krahtë e tua të dobët!

S'jeni në Evropë!

Nga Tirana për në "Evropë", dua të them edhe për në Azi, Afrikë, Amerikë dhe Australi, një herë në javë ka postë. Vapori italian të shtunën niset nga Durrësi dhe ajo govatë, me një thes me letra na vë në marrëdhënie me botën tjetër; nga Brindisi letrat marrin udhën, që u duhet, udhë që padyshim nuk dihet prej nesh. Vapori i sho-

qërisë italiane vjen afër mbremjes në Durrës dhe ngrihet pas mesnate, pothuajse ndaj mëngjesit. Vete në Vlorë dhe s'andejmi, të pasnesërmen, pra, të hënën, vete në brigjet e Italisë.

Mund të them se nuk rroj dot pa postë; mund t'i shtrohem privatësisë në çdo formë të saj, po jo të jem i prerë nga bota e jashtme. Dhe kjo postë e përjavshme më duket gjysmë burgim, një farë ndalimi dhe ndalim i hidhur.

Posta është mbyllur, që në nëntë të mëngjesit, - më përgjigjet nëpunësi, një të shtunë në orën 10.00.

S'e kuptoj. Vapori shkon nga Durrësi nga mesi i natës. Dhe posta mbyllet një ditë më parë! Dhe Tirana tek Durrësi për dy orë me automobil!

Mbete me letër në dorë, i keqardhur. Një javë akoma dhe unë që u ngriva në të ftohtë qysh në mëngjes, e shkrova letrën që ta sillja vetë. - Ç'ke, ç'ke akoma, më thotë Syrja Pojani, i biri i të ndjerit Orhan bej. Të shoh prapë me inat.

Syrjai është deputet i Matit, s'e di mirë pse. As ai më duket nuk e di. Qëndroj dhe i qaj hallin, i lumtur tani që gjej një deputet që të interesohet. Nëpunësit të postës s'kisha çfarë t'i thonja dhe inati ishte i kotë.

Pse s'e dhe që dje? më përgjigjet Syrjai me sarkazmë. Dhe si e pa që desha t'i

shpjegonja çështjen, t'i jepnja një mësim administrate, shtoi: "Po ti akoma e pandeh veten në Evropë ...."

E shoh se besedimi është i kotë. Jam akoma me letër në dorë. Dua të shoh se mos gjej ndonjë udhëtar dhe ta çoj në Durrës, që ta verë atje në postë. Kemi edhe tetë orë gjer sa të ngriset.

Po ja se ku pjek Eshref Frashërin, mikun e vjetër, bashkë me të cilin kërkonim të konvertonim çobanin Abdi në Eren-Qoj.

Eshref, miku im, ç'është kjo punë, ti që je kryetar i parlamentit, do të më kuptosh, është turp të rrëfejme kaq pakujdesi ....

Eshrefi më dëgjoi. Po, tani më s'të pëlqen Shqipëria, u mësove në Evropë, - më thotë.

Domethënë, ti Eshref, kryetar i Parlamentit, po më thua se Shqipëria s'është Evropë! Mbese mejon se është Afrikë? Po marr asht, ta diç!

Më vjen keq edhe një herë akoma. Letrën e kam gjithnjë në dorë. Ç'është ky mentalitet për ne: nuk mund të thuash gjësendi, pa të pozuar Evropën, sikur ishte një faj pse ke vajtur atje, ose sikur çdo send që duhet të bëhet në Shqipëri, nuk do bërë, sepse s'jeni në Evropë! ...

Myrteza bej, të lutem a mos di njeri që shkon në Durrës? Kam një letër.

Myrteza! më shikoi. Bej i Çokllavet mban hotelin Frashëri, rrjep botën, fiton të holla dhe tërë natën kërcet kumari.


Me një gjysmë ftohtësie më thotë se nuk di njeri për në Durrës. Pastaj më bën këtë qortim:

- Ama edhe zotrote punë na hape!

- Pse zotrote, ç'ke?

- Ç'është ai raport që i ke dhënë ministrisë për hotelet? - Or zot, më duket se kam të drejtë. Ju po fitoni mjaft dhe është fare e arsyeshme që të mbani dhe hotelet të pastër, mos jenë si hane fshati.

- Ama, ajo që të thua zotrote për Evropë s'bëhen, jo këtu! Në pesëmbëdhjetë minuta për herën e tretë po më hid-



het shuplaka Evropë në fytyrë.

Letra e mjerë më mbeti në dorëse ... nuk jemi në Evropë!

### PËRSHKRIM:

Kur qeshë në mëhallën vrenes Në maj 1913 vajta në Shkodër, ndjenja afër tri javë, pashë sende interesante. Datën që u ktheva në Vlorë, më duket se qerrja s'shkonte gjer në shtëpinë tonë, andaj zura një hamall për t'i dhënë valixhen dhe një thes të vogël me disa gjyle topi nga Taraboshi. Kur arrita në shtëpi, duhej të paguanja hamallin. E dinja që s'kërkonte të holla, po shpresoja që do të gjeja Abdi beun. Abdiu paska i kur nga Vlorë dhe tani në shtëpi rri Aziz pashë Vrioni; meqenëse edhe ky qe mik dhe i njohur, mund që të rrinja prapë në atë shtëpi, pra, mund t'i kërkonja edhe pak të holla hua për hamallin. Po ja, edhe Azis Pasha s'ishite në shtëpi!

Xhepat i kisha fare zbrazët e s'dinja ç'të bënja. Kur ja që u dha Bedri Pejani, miku dhe pak nxënësi im. Ja them hallin. Zë dhe kërkon: mezi gjen në thellësinë e një shumice xhepash pesëmbëdhjetë para. Kjo gjetje e Bedriut, më jep holla hua për hamallin. Filloj të rremoj në xhepa, të krruaj pëlhurat e palosura të xhakëtës e të jelekuat: Në çdo forcim, gjenja copëza kartash të fishkura, pluhur të ngjuar, sumbulla të vogla dhe të mbledhura, nuk e di nën çfarë tjetër akoma. Po si argjend, nuk gjeta veçse dy dhjeçe të zeza. Kamja jonë bashkët arrinte në tridhjetë e pesë para. Hamall kërkonte një grosh. Na duhej, pra, akoma pesë para, një pesësh i gjerë. Me gjasë se kam harruar ndonjë xhep, i nisa që të gjithë xhepat s'ish, me një zell të ri; por edhe fshetazta, me një shpresë të dëshpëruar: Kot!

Duke mos pasur tjetër shpëtim se edhe kërkimet e përsëritura të Bedriut s'dhanë ndonjë rezultat të ri, i zgjat mikut tonë barrëbartës të tridhjetë e pesë paratë, duke i thënë se do t'ia jepnja herë tjetër shumën, që mbetesh. Ai qe një burrë mesatar, nj



**Qepa e njomë është shumë e mirë edhe për bronkitin. Kundër tij këshillohet një përbërje me qepë dhe ujë. Për një mbrojtje të mirë imunitare, mjekët këshillojnë të prisni imët dy qepë, t'i lini ato të marinohen për disa orë në 500 ml ujë ambientit dhe të pini nga një gotë ndërmjet çdo vakti. Mund të pini edhe një gotë para se të flini.**



## Receta me qepë kundër rrufës, bronkitit dhe laringitit

miisht rekomandohet konsumimi i 3 kokrrave çdo dy orë. Pas tri ditëve të para uleni dozën, derisa të shëroheni plotësisht.

### BRONKITI

Qepa e njomë është shumë e mirë edhe për bronkitin. Kundër tij këshillohet një përbërje me qepë dhe ujë. Për një mbrojtje të mirë imunitare, mjekët këshillojnë të prisni imët dy qepë, t'i lini ato të marinohen për disa orë në 500 ml ujë ambientit dhe të pini nga një gotë ndërmjet çdo vakti. Mund të pini edhe një gotë para se të flini.

### LARINGITI

Kundër dhimbjes së fytit po japim recetën e shurupit me qepë që është shumë e thjeshtë për t'u përgatitur. Merrni 100 gr qepë, grijeni imët dhe për 10 minuta vëreni të ziejë në 200 ml ujë. Pasi ta hiqni, lëreni të ftohet dhe shtojni një lugë gjelle mjaltë. Vendoseni përsëri të ziejë derisa të krijohet një lëng pak i trashë. Nëse keni dhimbje fyti, pini 4 deri 6 lugë kafeje derisa të shëroheni.

### I FTOHTI

Kundër të ftohtit rekoman-

dohet verë e përzier me qepë. Përgatiteni këtë recetë që në momentin që temperaturat fillojnë të bien. Në këtë mënyrë ju nuk do e ndjeni shumë të ftohtin. Grini 300 gr qepë dhe shtypeni. Shtojni 100 gr mjaltë të lëngshëm dhe 600 ml verë të bardhë. Përziejeni mirë dhe pini 2 deri 4 lugë gjelle sapo të ndjeni ethe. E mira është që të pihet pak e freskët. Kujdes! Kjo pije përmban edhe alkool, kështu që mos e teproni.

**E**fektet kurative të qepës janë më të mëdha se ç'mund të mendoni. Qepa është e pasur me kripëra minerale dhe duke u kombinuar me substancat që ndodhen në organizëm stimulon një mbrojtje natyrale.

### RRUFA

Qepa e njomë është e rekomandueshme të përdoret për të sëmurët me rrufë. Kur ju sëmurëni me rrufë, e cila shkakton teshtima dhe rrjedhje hundësh, mundohuni të përdorni kokrrat e qepës së njomë. Filli-

## Studimi: Arrat ndihmojnë në parandalimin e kancerit të gjirit



**U**shqyerja është një "çelës" shumë i rëndësishëm për parandalimin e tumoreve. Ndërkohë që, aktualisht kanceri i gjirit është një nga shkaktarët kryesorë të vdekjeve të femrat e reja. Sipas një studimi, i cili hap shpresa të reja në parandalimin e kësaj sëmundjeje, mund të ishte i dobishëm konsumimi i arrave edhe në rastet kur kemi të bëjmë me predispozita gjenetike. Kërkuesit e Universitetit Marshall në SHBA, falë një testi të zhvilluar të kafshët kanë zbuluar se janë të mjaftueshme 50 gramë arra në ditë për të vepruar në mënyrë domethënëse në parandalimin e sëmundjes së kancerit të gjirit. Sipas studimit, përbërësit e këtij fruti,

që janë vitamina E, mineralet dhe një aminoacid i quajtur arginina, janë në gjendje jo vetëm të parandalojnë, por edhe të ngadalësojnë

avancimin e një tumori. Kjo, sigurisht, duke i konsumuar arrat në mënyrë të rregullt.



## E ëma i komentoi në foto, Oriola Marashi habiti me veprimin e saj

Oriola Marashi është një nga modelet më të njohura shqiptare, e cila merr vëmendje shumë të madhe sa herë që publikon foto e video seksi. Së fundmi, modelja ka publikuar një foto shumë provokuese ku shfaqet me gjoksin jashtë dhe në mes të qindra komenteve, ka rënë në sy ai i mamasë së Oriolës, Xhoi Jakaj. "Yyy bukuroshe e mamit, flokë arta ime ti. Dashuri!", ka shkruar mamaja Oriolës, në foton ku modelja shfaqet me njërin gjok jashtë. Nuk e dimë çfarë ndodhi, por komenti i mamasë së Oriolës është fshirë nga kjo foto dhe modelja ka ndryshuar përshkrimin e fotos, duke shkruar: "Tjetër klas".



## Fansat i bëjnë pyetje për gabimet drejtshkrimore, zbuloni reagimin e Kejvinës

Kejvina Kthella është kthyer në një nga personazhet më të komentuar të showbiz-it shqiptar, e cila merr vëmendje të madhe nga publiku për shkak të fotove provokuese që publikon në profilin e saj në 'Instagram'. Së fundmi, Kejvina u është përgjigjur pyetjeve të ndryshme që fansat i kanë bërë asaj në 'Instastory'. Një nga fansat e saj nuk mendon kështu, teksa e pyet Kejvinën se përse personat e famshëm bëjnë kaq shumë gabime drejtshkrimore. Sigurisht, që Kejvina e mori me sportivitet pyetjen teksa u përgjigj se Zoti nuk t'i jep kurrë të gjitha



## Alban Ramosaj fotografohet me një femër misterioze

Alban Ramosaj është një ndër djemtë më seksi të show bizz-it shqiptar. Ai është shumë i pëlqyer nga publiku, veçanërisht nga gjinia femërore. Albani është shumë aktiv në rrjetet sociale ku ndan shpesh me fansat poza të ndryshme që tërheqin vëmendjen e të gjithëve. Së fundmi, këngëtari ka publikuar në 'Instastory' një foto të nxehta nga vera që lamë pas, ku shfaqet i shtrirë krahu një femre misterioze, së cilës nuk ia ka zbuluar fytyrën. Ata shfaqen të dy të zhveshur teksa marrin rreze dielli, ndërkohë që në postim Albani ka



## Noizy tallet sërish me Kombëtaren shqiptare, ja çfarë ka bërë

Humbja e thellë e Kombëtares shqiptare me rezultatin 0-4 me Skocinë, ishte një lajm i hidhur për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen. Disfata e turpshme është pritur mjaft keq edhe nga reperi shqiptar Noizy, i cili i ka premtuar besnikëri skuadrës së Kosovës dhe ka ofenduar lojtarët e Shqipërisë duke i quajtur "lojtarë fasulesh". Noizy madje ka kërkuar largimin e trajnerit italian Panuçi, por Kombëtarja shqiptare fitoi mbremjen e së martës ndaj Uellsit me rezultatin 1-0. Pavarësisht humbjes së kaluar, Noizy e ka ndjekur sërish Shqipërinë, por nuk mund të mos ironizonte pak teksa shkroi: "Këtë radhë kishin hudhë çik pastërma" duke kujtuar faktin që më parë i quajti "lojtarë fa-



Aleksandër Vuçiq mbledh ambasadorët pas vendimit të qeverisë kosovare

# Kosova, luftë ekonomike Serbisë e Bosnjës: Rritet taksa 100%

## Haradinaj: Vendimi hyn në fuqi menjëherë

Mospranimi i Kosovës në INTERPOL është vetëm fillimi. Ndërkaq, Kosova i ka shpallur luftë ekonomike Serbisë dhe Bosnjës pas lobimit që kjo e fundit bëri për të mos qenë pjesë e INTERPOL-it. Qeveria e Kosovës ka miratuar rritjen e taksës me 100% për mallrat dhe produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnja. Gjatë mbledhjes së djeshme të qeverisë, ministri i Tregtisë së Kosovës, Endrit Shala propozoi që Serbisë t'i rritet taksa në 100% nga 10% që ishte më parë. "Nga sot t'i vendoset masa 100% produkteve me origjinë nga Serbia dhe Bosnja. Ka një asimetri të madhe sa u përket ofertave publike, ku kompanitë e Kosovës nuk mund të konkurrojnë ligjërisht në ofertat publike në Serbi. Në anën tjetër ka më shumë se 100 oferta publike, që kompanitë serbe kanë fituar në Kosovë. Probleme të tjera ka shumë. Kosova nuk mund ta zhvillojë industrinë e saj të transportit dhe humb qindra vende pune, sepse kamionët e Kosovës nuk lejohen ta përdorin Serbinë si vend transit për në tregun e BE-së", tha Shala. Ndërkohë, kryeministri i Kosovës përmes një postimi në "Facebook" u shpreh se ky vendim i qeverisë hyn në fuqi menjëherë dhe obligohen institucionet ta zbatojnë. "Nga sot, masë 100% ndaj Serbisë! Qeveria e Kosovës në mbledhjen e sotme ka marrë vendim që të vendoset masa prej 100% ndaj produkteve të importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, përjashtuar brendet ndërkombëtare të listuara në aneks. Po ashtu, qeveria e vendit obligon Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë dhe të gjitha institucionet relevante, që të largojnë dhe të ndalojnë importin dhe hyrjen potenciale në treg të të gjitha produkteve, të cilat nuk i referohen dhe janë në kundërshtim me emërtimin zyrtar dhe kushtetues të Republikës së Kosovës. Vendimi hyn në fuqi menjëherë, institucionet relevante obligohen ta zbatojnë po ashtu menjëherë", - shkroi Haradinaj. Vendimi i Kosovës ka ardhur pas fushatës që po e bën Serbia ndaj pavarësisë së Kosovës. Vendimi hyn në fuqi menjëherë, institucionet relevante obligohen ta zbatojnë po ashtu menjëherë", - shkroi Haradinaj. Vendimi i Kosovës ka ardhur pas fushatës që po e bën Serbia ndaj pavarësisë së Kosovës. Vendimi hyn në fuqi menjëherë, institucionet relevante obligohen ta zbatojnë po ashtu menjëherë", - shkroi Haradinaj.



Qeveria e Kosovës

### REAGIMI I NISHANIT

"Votimi kundër anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL nuk është gjë tjetër veçse mbajtja gjallë e armiqësisë në vend të pajtimit, është një urrëjtje në Ballkan në vend të mirëkuptimit, do të thotë mburojë për krimin e organizuar në vend të sundimit të ligjit. Kjo 'aleancë anti' është një reminiscencë e vjetër për të gjalluar hegjemoninë serbe kundër popujve të tjerë të Ballkanit. Turp! Shqipëria duhet të iniciojë me vendet e tjera të Ballkanit një proces izolimi ekonomik e politik ndaj platformës destruktive të Serbisë, e cila vazhdon të investohet me aleatët e saj në minimin e paqes dhe stabilitetit të Ballkanit.

Aleksandër Vuçiq do zhvillojë një mbledhje të jashtëzakonshme me ambasadorët e huaj në Beograd. Vuçiq ka thirrur në një takim të jashtëzakonshëm ambasadorët e Kinës, Rusisë, BE-së dhe vendeve të Qunitit, raporton media serbe "Tanjug". Sipas medias serbe, Vuçiq gjithashtu ka thirrur edhe një mbledhje të Këshillit për Siguri Kombëtare të Serbisë pas masave të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ven-

**RAMUSH HARADINAJ**  
"Nga sot, masë 100% ndaj Serbisë! Qeveria e Kosovës në mbledhjen e sotme ka marrë vendim që të vendoset masa prej 100% ndaj produkteve të importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, përjashtuar brendet ndërkombëtare të listuara në aneks. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe institucionet relevante obligohen ta zbatojnë po ashtu menjëherë", - shkroi Haradinaj.

### SHKURT

**Mal i Zi, stuhi e pazakontë përfshin vendin**

Gjatë orëve të fundit Mali i Zi u godit nga një stuhi e pazakontë shirash. Stuhia ka shkakuar përmbytje dhe rrëshqitje toke kryesisht në qytetet përgjatë bregdetit, por edhe në Podgoricë. Autoritetet evakuuan 120 fëmijë të një shkollë që u gjenden pa pritur të izoluar mes përmbytjeve në qytezën Radanoviç. Përmbytjet janë bërë shkak për mbylljen e përkohshme të institucioneve arsimore. Në Budva, një pjesë e qytetit është pa energji elektrike nga dëmtimi i linjave. Moti i keq ka shkakuar probleme edhe në Kroaci e Bosnje.

dimi i djeshëm i Qeverisë së Kosovës për të rritur taksën me 100% për mallrat serbe dhe boshnjake është marrë si kundërpërgjigje për fushatën agresive të Serbisë kundër Kosovës. Gjithashtu, me mospranimin e Kosovës në Interpol për shkak të lobimit të rëndë të bërë nga Serbia, ka reaguuar edhe ish-presidenti shqiptar. Një reminiscencë e vjetër për të gjalluar hegjemoninë serbe kundër popujve

të tjerë të Ballkanit. Kështu e ka cilësuar ish-presidenti Bujar Nishani votimin dje kundër anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL. Në një mesazh në faqen e tij të "Facebook"-ut, Nishani thekson se kjo votë ishte veçse mbajtja gjallë e armiqësisë në vend të pajtimit. Po ashtu, i bëri thirrje qeverisë shqiptare që të nisë një politikë izolimi ekonomik e politik ndaj platformës destruktive të Serbisë.

## Albin Kurti, thirrje politikës: Ja kërkesat për Serbinë

### Kreu i 'Vetëvendosjes': Kërkojini të na njohin pavarësinë e të na dëmshpërblejnë për luftën

#### KËRKESAT

- Njohja juridike e Kosovës nga Serbia dhe kërkesa që ajo të ndryshojë kushtetutën e saj dhe ta heqë fjalinë ku thuhet se krahina e Kosovës dhe Metohisë është pjesë e territorit të Serbisë.
- Zbardhja e fatit të të pagjeturve. Në Kosovë ka pasur krime lufte e krime kundër njerëzimit, të cilat i ka kryer Serbia dhe ende nuk ka kërkuar falje.
- Reciprociteti i njohjes së të drejtave të pjesëtarëve të Kosovës që jetojnë në Serbi e anasjelltas.
- Të na i kthejë regjistrat civilë e kadastrave. Të na e paguajë dëmin e luftës.

në vend. Nuk mund të pajtohemi me Serbinë, nëse nuk pajtohemi me njëri-tjetrin rreth këtij raporti", ka thënë Kurti. Po ashtu, ai tha se Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi duhet t'i ndalë pazaret territoriale me Serbinë. "Jam optimist që mund ta ndërtojmë konsensusin parlamentar e qeveritar për

kërkesat tona ndaj Serbisë. Është dëm i madh për demokracinë tonë që na ka hyrë Serbia në mes e na ka përçarë", tha ai. Sipas Kurtit, kjo listë do të duhej të përmbante këto kërkesa:

"Njohja juridike e Kosovës nga Serbia dhe kërkesa që ajo të ndryshojë Kushtetutën e saj dhe ta heqë fjalinë ku thuhet se krahina e Kosovës dhe Metohisë është pjesë e territorit të Serbisë.

"Zbardhja e fatit të të pagjeturve. Në Kosovë ka pasur krime lufte e krime kundër njerëzimit, të cilat i ka kryer Serbia dhe ende nuk ka kërkuar falje.

"Reciprociteti i njohjes së të drejtave të pjesëtarëve të Kosovës që jetojnë në Serbi e anasjelltas.

"Të na i kthejë regjistrat civilë e kadastrave. Të na e paguajë dëmin e luftës.

#### Njoftim shitje me ankand

Shoqëria përbarimtare "AA Baliff" shpk, zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Trulli 128 m2 dhe ndërtesë 81 m2, me Nr. pasurie 2/339, ZK 8511, vol. 15, fq. 127, ne pronësi të Qemal Mahmut Skora e regjistruar në ZVRPP Durrës.

Cmimi i ankandit të treta është EUR 40,118 (dyzetë mijë e njëqind e tetëdhjetë euro).

Ankandi zhvillohet dt. 03.12.2018, ora 16.00 në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Kati i III-të, Tiranë.

Kontakt: cel. 0688012846, ose në adresën e email: aabaliff@gmail.com.

#### Shoqëria përbarimtare JUSTITIA

Shoqëria përbarimtare JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vene hipoteke NGB BANK, me këto të dhëna:

Trulli Zk.3064 nr.pasurie 80/2/1 vol.2 fq.240 94 m2 ndërtesa 250 m2. në pronësi të Ali Ibrahim Alushi ndodhur në adresën Prush, Tiranë.

Ankandi zhvillohet në datën 05.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbarimit gjyqësor me Adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890 CEL. 0693177499.



## Një koreano-jugor për 2 vite në krye të INTERPOL-it

### Me votat e 94 vendeve, Kim Jong-yang zgjidhet në vend të përkrahësit të Putin

Agjencia Policore Ndërkombëtare Interpol do të drejtohet nga Kim Jong-yang, Koreano-jugori, i cili prej 2015-ës mbante postin e nënpresidentit të kësaj agjencie për Azinë, u zgjodh me votat e 94 vendeve anëtare gjatë asamblesë në Dubai për një mandat 2-vjeçar. Kandidatura e tij shmangu zgjedhjen në krye të INTERPOL-it të nënpresidentit tjetër,



Kreu i Interpolit, Kim Jong-yang

gjenral-majorit nga Rusia, Aleksandër Prokopçuk, njeri i afër me presidentin Putin. Shtetet e Bashkuara dhe vendet europiane kundërshtuan fortë zgjedhjen e tij, duke paralajmëruar se do të largoheshin nga INTERPOL-i për të krijuar një organizëm të ri ndërkombëtar policor paralel. Një grup

senatorësh amerikanë, në një letër drejtuar vendeve anëtare të Interpolit, paralajmëronin se Rusia mund ta keqpërdorte fuqinë e kësaj organizate nëse drejtimin e merrte njeriu i Moskës. Kim Jong-yang zëvendëson në detyrë Meng Honguei, i cili u zhduk në muajin shtator dhe më pas dha dorëheqjen pasi autoritetet kineze thanë publikisht se kishin nisur ndaj tij një hetim për korupsion.

## Drejtoresha e konfederatës së industrisë: Brexit po konsumon qeverinë

# Dalja e Britanisë nga BE, ligjvënësit s'votojnë marrëveshjen

## Theresa May rrezikon postin e kryeministres

Vijon ende gjendja e ndërë politike në Britani për shkak të Brexit. Ndërkohë tanimë Britania po përballet me një dramë politike të rrezikshme, ndërsa kryeministria Theresa May përpigjet të sigurojë mbështetjen e Parlamentit për marrëveshjen e shkëputjes nga Bashkimi Europian, për të cilën u ra dakord javën e kaluar. Ligjvënësit janë zotuar të mos e votojnë marrëveshjen, ndërsa anëtarët e partisë së saj po përpigjet ta largojnë nga posti zonjën May. Ndërkohë, kundërshtarët e shkëputjes shpresojnë që kaosi i krijuar të mund të sjellë një referendum të dytë lidhur me largimin nga Europa. Të hënën, udhëheqës të biznesit në Britani bënë një paralajmërim të ashpër lidhur me koston në rritje të pasigurisë së krijuar nga Brexit: "Brexit po e konsumon qeverinë, çdo politikan, apo punonjës civil, është duke dëmtuar gjithashtu biznesin e Britanisë. Firmat tona janë duke shpenzuar me qindra miliona paund për t'u përgatitur për skenarin më të keq", - tha drejtoresha e konfederatës së industrisë britanike, Carolyn Fairbairn. Kryeministria Theresa May thotë se marrëveshja do të jetë diçka e mirë për biznesin, duke bërë të mundur rekrutimin e talenteve nga e gjithë bota: "Nuk ka për të ndodhur më që europianët, pavarësisht nga aftësitë dhe eksperiencat që kanë, të kenë përparësi punësimi ndaj inxhinierëve nga Sidnej, apo programuesve nga Delhi", - tha zonja May. Ky premtim synon të qetësojë përkrahësit e Brexit-it, që thonë se marrëvesh-



Kryeministria e Britanisë, Theresa May

ja për largimin nga Bashkimi Europian e lë Britaninë shumë pranë grupit. "Përkrahësit e Brexit-it e kanë reklamuar gjithmonë atë, me idenë se përmes Brexit-it, do të arrihen një numër i madh marrëveshjes tregtare me vendet me zhvillim të shpejtë ekonomik, si ato aziatike dhe SHBA. Problemi me të cilin këto vende tani përballet është se Theresa May është angazhuar për një sistem të përbashkët doganash, që do të thotë se Britania para se

gjithash delegon pushtet përmes tarifave të saj dhe ndoshta edhe përmes elementëve të tjerë të politikës së saj të jashtme ndaj BE-së", - thotë John Springford, i Qendrës për Reformën Europiane. Një numër ministrash britanikë dhanë dorëheqjen në shenjë proteste, ndërsa të tjerë po përpigjet ta detyrojnë Theresa May-n ta modifikojë marrëveshjen. Por si kryeministria britanike, edhe Bashkimi Europian, thonë se negociatat për tërheqjen nga marrëveshja

kanë marrë fund. Me shtimin e rebelimit, anëtarët konservatorë të parlamentit mund të kërkojnë që këtë javë, një garë për ndryshimin e udhëheqjes. Edhe në se Theresa May do të mund të mbijetojë, shumica e ligjvënësve janë zotuar se do të votojnë kundër marrëveshjes. Kjo mund ta zhysë përsëri në kaos politik Britaninë. "Vlera e paundit britanik ka për të rënë. Ka për të pasur një presion të madh nga tregjet dhe nga bizneset, që do të thonë: Du-

het të kemi medoemos një marrëveshje". Një tjetër skenar është që zonja May të japë dorëheqjen. Nuk ndodh që qeveria të krijohet nga parlamenti, prandaj do të lindë nevoja për zgjedhje të përgjithshme, megjithëse mendoj se kjo nuk mund të ndodhë. Atëherë mundësia e vetme mbetet një referendum i dytë lidhur me Brexit", - thotë zoti Springford. Ndërsa anketat tregojnë se britanikët tani duan që çështja e Brexit-it të rishikohet, ka dy hamendësime: mundësia e një referendumi të dytë dhe largimi i detyruar i Theresa Mayt nga posti. Këtë javë ajo shkon në Bruksel për bisedime lidhur me "Deklaratën politike", që përvijon lidhjet e ardhshme të Britanisë me BE-në. Por ky dokument nuk ka obligime ligjore dhe kritikët e zonjës May thonë se ajo nuk duhet të paguajë faturën e 50 miliardë dollarëve të Britanisë për shkëputjen nga BE-ja për detyrimet ekzistuese, pa dhënë garancitë më të forta për një marrëveshje tregtare. Me afrimin e afatit të marsit të 2019-es, po shtohen pasiguritë, ndërsa politikanët dhe populli në Britani duken përherë e më të përçarë.

## SHKURT

### Përmbytjet pushtojnë shkretëtirën

Përmbytjet kanë pushtuar edhe shkretëtirën këto ditë. Në javët e fundit shirat e rrëmbyer kanë goditur rajonin e Lindjes së Mesme, duke shkakuar viktima në të gjithë gadishullin arab. Si pasojë 30 persona kanë gjetur vdekjen nga stuhitë e papritura që janë verifikuar në Arabinë Saudite, Kuvajt, Jordani dhe Iran. Në Jordani kushtet ekstreme atmosferike kanë detyruar autoritetet të evakujnë me urgjencë 4 mijë turistë në qytetin antik të Petrës. Në Kuvajt janë mobilizuar ushtria dhe garda Kombëtare për t'u ardhur në ndihmë banorëve. Sipas parashikimeve, moti i keq do të vijojë edhe javën e ardhshme ndërkohë që edhe një ciklon po spostohet drejt rajonit. Pamjet e përmbytjeve tregojnë sesi rrugët e Riadit, kryeqytetit të Arabisë Saudite janë transformuar në lumenj të vegjël dhe sistemet e kanalizimeve duken jashtë funksionit duke shkakuar trafik dhe kaos në shumë rrugë kryesore. Kjo situatë e rëndë si pasojë e shirave dhe përmbytjeve u verifikua edhe në Izrael, Liban dhe Siri gjatë ditëve të fundjavës.

### Francë, Macron mbron rritjen e taksave të karburantit

Presidenti francez Emanuel Macron mori në mbrojtje rritjen e taksave të karburantit që ka nxitur protesta në mbarë vendin, por bëri thirrje për 'dialog' për të zburuar tensionet. Në komentet e tij të para rreth protestave, që nisën të shtunën kur më shumë se një çerek milion shoferë bllokuan rrugët, zoti Macron pranoi se është "normale" që njerëzit të shprehin shqetësim. Ai tha se po përpigjet të "ndryshojë zakonet" duke i joshur francezët të mos përdorin karburante. Zoti Macron përsëriti premtimet për ndihmë ndaj familjeve me të ardhura të ulëta për të blerë makina më të pastra ose për të kaluar në metoda më të pastra ngrohjeje për shtëpitë. Ai nuk komentoi për dhunën gjatë protestave. Një protestues humbi jetën të shtunën në një aksident rrugor dhe qindra u plagosën. Presidenti Macron, popullariteti i të cilit ka rënë, i bëri komentet gjatë një debati universitar në Belgjikë, ku studentët protestues ngritën një pankartë dhe hodhën letra në auditor.

**Njoftim për shitje me ankand të dytë**

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nënin 568, 577ë vijues te K.P.L.C do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e palës debitore B Kamberaj dhe L Kamberaj. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga:

- "Truall" - Godinë tre katëshe, me numër pasurie 14283 ne Z K Nr.8602, volumni 35, faqe 144, truall 300 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e katit perdithe 117.9 m<sup>2</sup> ne Lagjen 10 Korriku
- Ankand i dytë i pasurisë fillon me cmin fillstar në masën 6.272.000 Lekë.
- Ankand i gjashtë i hapur 30 ditë dhe do të zhvillohet në datë 14.12.2018 në orën 15:00 në Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kat 2, Zyra nr. 5. Tiranë. Ofertuesit duhet të nriheqin dokumentacionin të kontaktin me shoqërinë si dhe mund të vizitojnë faqen WEB [www.powerjustice-al.com](http://www.powerjustice-al.com).

**Njoftim për shitje me ankand**

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nënin 568 te K.P. Civile ka shpallur shitjen me ankand të parë për pasurinë e palajshme të palës debitore, hipotekuese dhe palës dorëzuesit:

- "Toka Ate" nr Z K 1987 me numër pasurie 3038 Volumni 19 Faqe 71, me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup> me cmin fillstar prej 72.520 Euro
- "Toka Ate" nr Z K 1987 me numër pasurie 4056 Volumni 11 Faqe 92, me sipërfaqe 1730 m<sup>2</sup> me cmin fillstar prej 125.460 Euro
- "Toka Ate" nr Z K 1987 me numër pasurie 2573 Volumni 15 Faqe 239, me sipërfaqe 2.000 m<sup>2</sup> me cmin fillstar prej 122.640 Euro
- Ankand i gjashtë i hapur për 15 ditë dhe do të zhvillohet në datën 06.12.2018 prej orës 15:00, pranë sallës në Bulevardi "Gjergj Fishta" Pall. i shoqërisë "Gara" Kulla 1, Kat 2, Zyra nr. 5. Ofertuesit mund të kontaktojnë me sh "Power & Justice"(P&J) sh.p.k dhe vizitojnë faqen WEB [www.powerjustice-al.com](http://www.powerjustice-al.com).

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

A. Pasuria nr. 26/319, e llojit 'truall', vol. 27, fq. 207, zk. 8642, sip. 10.000 m<sup>2</sup>, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;

B. Pasuria nr. 26/320, e llojit 'truall', vol. 27, fq. 208, zk. 8642, sip. 10.000 m<sup>2</sup>, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;

**ÇMIMI 49.754.800 LEKË** për secilin pasuri; në Total 99.509.760 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 03.12.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

## LIBRI

# Dhimbja si art në poezinë danteske të Flutura Ačkës

Nga Shaban Murati

Nënat e përjetojnë dhimbjen si askush. Poetët e kën dojnë dhimbjen si askush. Kur je edhe nënë, edhe poete e talentuar, dhimbja shndërrohet në art sublim si në vëllimin e ri dhe të papërsëritshëm poetik "Roja i dritës", i poetes së mirënjohur Flutura Ačkës.

Zhbirimi poetik dhe filozofik në poezinë e saj ekranizon në shpirtin dhe mendjen e lexuesit dhimbjen si identitet i jetës. Është një këndvështrim sa origjinal, aq edhe novator, i poetizimit të dhimbjes si ekzistencë e jetës, jo si kërkim ngushëllimi, por si beteja e përtjetshme e shpirtit me materien, e njeriut me jetën, me të papriturat dhe me pamundësitë e saj. Siç thotë poetja: "Gjithfarë kimie e shpikur/ sulmon kiminë e lindur/".

Si një art vërtet i madh, poezia e Flutura Ačkës e sjell tronditjen tragjike të humbjes së djalit të saj si një përjetim i domethënies së vetë qenies njerëzore, të dimensionit të shpirtit me kujtesën dhe me shqetun e pafund të dhimbjes, si një raport të ekzistencës dhe mosekzistencës së njeriut. Poetika e saj nuk qëndron në radhët e ferrit shpirtëror personal, që shkakton një tragjedi shpirtërore dhe e pazëvendësueshme personale, por hulumton në të panjohurat e rrokullisjes sizifiane të shpirtit dhe të mendjes së njeriut, i cili ecën përmes dhimbjes për të qëndruar tek jeta dhe për të vazhduar jetën. "Askush nuk e din dhimbjen e tjetrit përveç atij, që e ka", - thoshte Shekspiri. Dhe është vetë Shekspiri, që përgjithësoi dhe ngriti në artin e pavdekshëm të tragjikes dhimbjen njerëzore. Duket është impuls i shkrimtarëve dhe poetëve të mëdhenj, që ndajnë këtë nevojë artistike të brendshme, njerëzore dhe estetike për të shndërruar dhimbjen në art. "Ajër me ngjyrën e mungesës,/lërmë takim diku,/vij!/"

Është dhe merita e rrallë artistike e vëllimit poetik të Flutura Ačkës, që sjell poetikisht të lexuesi jo vetëm shpirtin e vet të plagosur, por edhe ndjenjën e përbashkët njerëzore të dhimbjes si element i pandarë i jetës. Është një proces dramatik i jetës dhe i kuptimit të domethënies panjerëzore dhe mbikohore të dhimbjes, që përshkon tërë faqet e vëllimit poetik, i cili të mban ngulitur me poezitë dhe vargjet e tij tronditëse, me forcën e fuqishme të fjalës poetike dhe me një figuracion shpërthyes e plot përmbajtje filozofike.

Dashuritë janë një kërkim poetik i pafund. Por vështirë të ketë dashuri të përtjetshme dhe me thellësi të ngjashme si ajo e nënës



Flutura Ačka

për birin e saj të vetëm. "Lëkurën e mallit biroj hidhërimi/ e regji, më nuk mban/tani brendinë han/". Një dashuri e veçantë, të cilës shpirti i rezervon dimensione dhe hapësira dhe përtej kohës, që nuk krahasohen me dashuritë në korrelacione të tjera. Sepse dashuritë e tjera janë të lidhura me materien, me përkohësinë fizike të njeriut, me vetëm njërin nga fazat e

moshës së njeriut, kurse dashuria e nënës për fëmijën është eterne dhe e lidhur me rrënjët e shpirtit dhe përtej kohës e përtej botës.

Dhimbja është momenti traumatik i shpirtit dhe i mendjes, të cilat prirën të ngurtësojnë momentin e dhimbjes dhe t'i japin një karakter statik. Por arti i vërtetë poetik i Flutura Ačkës arrin më të vështirën, duke e bërë dhimb-

jen dinamike në kuptimin e shprehjes së thellësisë dhe pakufizshmërisë së dhimbjes, duke e poetizuar dhimbjen për ta ndërë dhe përjetuar më shumë atë, duke e shkëputur nga personalja tek njerëzoria, nga tragjizmi i vetes tek tragjizmi i vetë ekzistencës së njeriut në një botë rastësish dhe kombinimesh fatkeqe të rasteve, që nuk varen nga njeriu

dhe as nga gjeografia apo historia e tij. "Dhe qenia e hutuar kthehet në qenie e pahutuar/ në pranverën e mekët/ zgjedh të mbjellë, pemën/ e shpresës/".

Poezia e Flutura Ačkës në vëllimin "Roja i dritës" merr një frymëmarrje, një mistikë, një përjetim filozofik dhe një nivel të lartë të shprehjes artistike të ngjashëm me artin poetik dantesk. "Lëre moskundin e harimit./ të luajmë me të harruarit./ që e kanë fikur grishjen për botën./ Jasthtë trumba e zogjve./ është më rebele se yshtja jote./ për ta shpallur zgjimin./ Ti, pranuesi i fatit./ pa lutje, pa lot, pa peng e pa mëshirim./çeli sytë/".

Rrathët e ferrit personal, arti i saj i fuqishëm poetik i përcor tek lexuesi si rrathët e ferrit të shpirtit dhe të ekzistencës së njeriut, të cilat poezia ka mision t'ia mësojë lexuesit. Shpërthimet ndjesore, mendimtare, figuracioni dhe metaforat e fuqishme, zbrëthimi i shpirtit njerëzor dhe i fatit njerëzor në momentin e tyre më të vështirë siç është dhimbja, në dimensionet e simbiozës së tokësore me qielloren, i japin poezisë së këtij vëllimi poetik një rrezatim dhe fuqi artistike shpeshherë të pazakontë. Është arti i magjishëm i dhimbjes si art në poezinë danteske të Flutura Ačkës. Një vëllim poetik si një prurje e re novatore artistike në poezinë shqipe nga njëra prej individualiteteve më të shquara të lettrave shqipe në ditët e sotme.

## 60-VJETORI I ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË NË UNESCO

### "DRITARE NË ARTIN MESJETAR SHQIPTAR", ÇELET EKSPOZITA NË PARIS

Ekspozita "Dritare në artin mesjetar shqiptar" u çel dje në Paris me rastin e 60-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në UNESCO. Në ceremoni ishin të pranishëm Ernesto Renato Ottone Ramirez, zëvendës drejtor i Përgjithshëm për Kulturën në UNESCO; ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro; zëvendësministrja e MPJE, Artemis Dralo; ambasadori i Shqipërisë në UNESCO, Ferit Hoxha dhe personalitetet e ambasadorë në UNESCO. "Çfarë mund të bëjmë për të promovuar paqen në botë? Kjo është çështja që UNESCO-ja shtroi për zgjidhje që kur u krijua në vitin 1945, fill pas luftërave që përgjakën botën. Një përgjigje për këtë na e ka dhënë shenjtoria jonë shqiptare, Nënë Tereza: "Shko në shtëpi dhe duaj familjen tënde!", - u shpreh ministrja



Kumbaro në fjalën e hapjes. Kjo ekspozitë në Paris, në sallën "Miro", përbën një rrugëtim në historinë e pikturës bizantine dhe pasbizantine të zhvilluar në territorin shqiptar dhe fton publikun e gjerë dhe studiues të fushës në një eksperiencë të rrallë në njohjen e mjeshtrëve eponim dhe anonim si dhe atelieve më të spikatura të

kohës, nëpërmjet veprës së trashëguar prej tyre. "Kur Shqipëria hyri në UNESCO, 60 vite më parë, ende nuk e kishim zgjidhur problemin e paqes me veten, ndaj dhe për më shumë se 30 vite pra ndaj studiues të fushës në një eksperiencë të rrallë në njohjen e mjeshtrëve eponim dhe anonim si dhe atelieve më të spikatura të

tjetrit. Ky është thelbi. Dhe njohja nis nga zakonet, traditat, mënyra e jetesës, të shprehura në arkitekturën e shtëpive, qendrave historike apo objektet e rralla, pra në trashëgiminë materiale dhe shpirtërore që mbart gjithsecili, nis kështu nga kultura", - u shpreh më tej në fjalën e saj Kumbaro.

"UNESCO mbetet e pazëvendësueshme në këtë rol unik të rëndësishëm që i jep arsimit, kulturës, vlerave të qytetërimeve, të cilat përbëjnë garantimin e stabilitetit të vendeve tona, të cilat do të shpëtohen nga kultura. Shqipëria bëhet pjesëmarrëse në krijimin e vlerave të përbashkëta të qytetërimit evropian, për të cilin kemi strukturën dhe të cilën ne dëshirojmë të zhvillojmë së bashku, sepse e kaluara që ne e ruajmë së bashku do të jetë themeli i së ardhmes sonë", - shtoi Kumbaro në fjalën e saj.

## SHFAQJA

# Drita dhe hijet e Skënderbeut tek ansambli "Shota"

Nga Josif Papagjoni\*

Jam në festivalin e teatrit "Ndryshe" në Podujevë, edicioni i dhjetë. Regjisori e kritikë Agron Gërguri, që ka simpatinë time për guximin e tij për t'i thënë hapur mendimet na priti mua dhe kritikun dhe shkrimtarin Miho Gjini. I bëmë një vizitë teatrit që mbante emrin "Avdush Hasani", një nga emrat-mit të teatrit shqiptar në Kosovë. Agroni, racional nga natyra e tij, e kishte tradhtuar veten dhe diç e re ia kishte rrëmbyer mendjen dhe zemrën. Qe shprehja e një emocioni të sinqertë, i një pune të pagme që ishte bërë me rikonstruksionin e teatrit, sikundër edhe disa ide që ai donte t'i bënte realitet së shpejti (një bibliotekë të vogël e sallë leximi, ndofta dhe një holl-kafeteri për artistët). Gëzimi e entuziazmi i tij më jepte shpresën se ky qytet i hapur, pranë kufirit me Serbinë, nesër do gumëzhinte sidomos nga rinia, duke e mbushur sallën e re të teatrit e duke e vjelë gjithë kënaqësinë dhe hirin poetiko-filozofik që teatri jep, si arti më publik, ku perceptuesi shndërrohet në bashkëpjesëmarrës të aktit krijës dhe ku realizohet, ndofta, ndikesa më e thellë e më e jashtëzakonshme në vetëdijen e njerëzve.

E para shfaqje e festivalit ishte premiera "Kumt" e Ansambli shtetëror të Kosovës, "Shota". E kisha parë një muaj më parë në skenën e teatrit në Dibër të Madhe dhe diçka pata shkruar për të. Një shikim i dytë përherë është sa i befasishtëm, aq dhe verifikues për mendjen dhe shijen e një kritiku, duke shërbyer si një test i njëmendtë për vlerën dhe dobësitë e shfaqjes, pasi e papritura e subjektit, e gjetjes, e formës, e vetë performimit shter-in si të tillat dhe atëbotë nis e konkurren veçse epërsia e vlerës artistike, s'ke ku strukuresh e as mbuloresh dot me të tjera gjëra veç artit si fuqi hipnotike dhe ripërtëritëse. Kur kjo gjë është e arritur, e pjekur, asisherë bujrum në teatër, ti vjen edhe të dytën herë, edhe të tretën herë e me tej, sepse diçka të re pikas tashmë në interpretim, a në konceptin koreografik, a në valle, a në muzikë etj. Unë mbeta serish i emocionuar dhe i këndellur nga tema e kapur, epoka e madhe e Skënderbeut, e ideuar bukur mirë nga trupa e këtij ansambli bash në vitin e Skënderbeut (2018). Më begatonte aty simbolika e figurës së heroit tonë, e kthyer në mit dhe nord-orientimi për kombin tonë etj. Ky subjekt, paçka se i hapërdarë, me mjetet e baletit na erdhi si një ravijëzim i hollë i bëmës së Kastriotit, pra jo si një subjekt i plotë, koherent dhe i tërësishtëm. Krijuesit kishin parapëlqyer formën e një mikseri, një farë tabloje ko-



## Kumti që dhanë valltarët me zhdërvjelltësinë e tyre plastike

ashtu dhe toni epiko-heroik. Po ashtu, mendimi muzikor ishte fort shprehës edhe në tablonë e fundit, ku ndjehej pëstjellimi, pesha e rëndë e pushtimit, humbja e dritës dhe e udhës, sundimi i territ: diçka vërtet e bukur, me një semantikë muzikore tejet të qartë dhe emocionale. Vlerë të veçantë i shtoi shfaqjes edhe kostumografiaja

Vlerë të veçantë i shtoi shfaqjes edhe kostumografiaja e Vesa Krajës, e cila solli kostumin tipik verior të burrave-luftëtarë me tirqin dhe përpunimin e xhamadanit, duke lënë të lirë e të dukshme hijeshinë trupore të meshkujve me gjokset, krahët; po ashtu kostumi i burrave nga trevat jugore me fustanellë, dhe sidomos kostumet e hijshme të grave.

e Vesa Krajës, e cila solli kostumin tipik verior të burrave-luftëtarë me tirqin dhe përpunimin e xhamadanit, duke lënë të lirë e të dukshme hijeshinë trupore të meshkujve me gjokset, krahët; po ashtu kostumi i burrave nga trevat jugore me fustanellë, dhe sidomos kostumet e hijshme të grave, ajo finisë dhe elegancë, që sillte aromën kulturore të epokës mesjetare shqiptare, paraturke, fustanet e gjatë e të lëshuara, elegante, qëndistartitë, prerjet. Më la mbresë ndër të kostumi arbëresh, që sikur të sillte ndërmend mjediset tipike të kostumeve evropiane të kohës. Doemos e kuaja dhe e zeza, herë e plotë, si pelerinë grash (e zeza) apo burrash (e kuaja), mëngët e gjera a ravijëzimet në tirqe, fustanet, jelekët, xhamadanët etj., afërmendsh se ishin shprehja e qartë e simbolikës sonë, dyngjyreshit të fl-amurit: Kuq e Zi.

Koreografia e Gjergj Prevazit kishte punuar në krijime blloqesh e radhësh me valltarë, për të dhënë dimensionin e gjerë të ngjarjes dhe aspektin popullor: Skënderbeun mes luftëtarëve dhe popullit të tij. Sakaq, përtej një tërësie të menduar mirë, koreografi kishte ndërkallur në trupin e shfaqjes dy episode kuptimplotë, bartës të një mendimi e konotacioni sa simbolik, aq dhe domethënë në rrafshin e asaj çka Gjergj Kastrioti bëri me popullin e vet dhe luftëtarët e tij. E para, teksa prijësit shqiptarë luftonin e përgjakeshin shoqi me shoq, Skënderbeu ndërhynte dhe me shtatën e tij veçonte shtpatat e tyre në dasitë dhe armigjësitë mes princave e principatave duke e mbledhur grusht parinë shqiptare në një dorë të fortë trimërore dhe udhëprijëse. Ai i fronte princat dhe shqiptarët të braktisnin mëritë, përçarjen dhe të rrinin se toku të

bashkuar nën komandën e tij kundër shtpatave turke, kundër pushtimit. Qe një ide e rrokshme, e bukur dhe me një gjuhë koreografike të hirshme. E dyta ishte lindja e djalit të Skënderbeut me nusen e adhuruar të tij, Donikën (e interpretuar nga balerina e hijshme Artiola Shala). Heroi heq përkrenaren e tij dhe e vendos mbi djepin e djalit të vet. Burra e gra bashkohen rreth djepit dhe përkrenares, e cila ndriçohet nga sipër me një dritë të fortë, bëhet e kuptueshme se përkrenarja e Skënderbeut dhe rrjedha e gjakut si trashëgimtar i mbretërisë, shndërrohet në simbolikën e prijës dhe prijësit prej idealit kombëtar që Gjergji ynë i Madh nënkuptonte. Do të doja që shfaqja të mbyllej këtu, e mbushur krejt nga drita, nga uniteti, nga shpresa, nga ideali prijës i epokës skënderbe-jane, si kumti përtëritës i mbijetesës së kombit. Por koreografi pas kësaj skene kishte zhvilluar një episod dramatik: turbullirën, kaosin dhe errësirën që pllakosi Arbërinë pas vdekjes së Skënderbeut dhe pushtimin tonë 500-vjeçar nga perandoria e zezë otomane, që na solli aq pasojë, vdekje, shndërrime e katastrofa. Kjo është e vërtetë, drita e Skënderbeut humbi përkohësisht sepse koha e pushtimit që tmerrësisht e gjatë, mundonjëse, gati gëlltite e zhbërëse për krejt kombin tonë, me shkaktërimin ekonomik, varfërinë, largimin si mendësi nga Evropa, me konvertimin e frikshëm religjioz (nga të krishterët në muslimanë), me sundimin e paditurisë dhe imponimin e një antropologjie lindore mbushur përplot humnera, golle, zhbërje, shpërndërrime katastrofale, largim nga rrënjja e vet etj. Historikisht kjo është e vërtetë, por si strukturë koreografike dhe artistike them se nuk i shkonte karakterit të shfaqjes. Nuk jam për zgjidhje ske-matike, por nuk do ta çmoja si të tillë një zgjidhje ku drita, shpresa, perspektiva historike nuk errësohen. Se po kaq historike është dhe ana tjetër, që zulma dhe emri i Skënderbeut jo më kot u kap nga arbëreshët e Italisë fillimisht, që qenë jashtë rrethit të pushtimit, më pastaj nga gjithë rilindja jonë, i kthyer në ideal kombëtar prijës. Dhe ishte pikërisht ajo dritë dhe ai ideal skënderbejan që u bë themeli i shtetit shqiptar dhe sot na prin atje ku e kemi realisht vendin, në Evropë, me vetëdijen, kulturën, qytetërimin që ajo përfaqëson. Gjithsesi, shfaqja koreografike "Kumt" e ansambli shtetëror artistik "Shota" të Kosovës pruri në çelje të festivalit të teatrit "Ndryshe" në Podujevë atë që të gjithë e duam, e përhirojmë, e ruajmë thellë në kujtesën tonë kolektive: Skënderbeun dhe zulmën e tij të patejkalueshme e frymëzuese ndër breza...

\*Kritik

Mesazhi *i* Ditës

# OSBE mirëpret angazhimin e Ramës për lirinë e medias

Nga Bernd Borchardt

(vijon nga faqja 1)

... kemi mbështetur në mënyrë aktive:

" Vetërregullimin e medias, si alternativë ndaj rregullimit të medias nga ana e qeverisë.

" Rritjen e nivelit të profesionalizmit të gazetarëve, edhe përmes trajnimeve.

" Procesin e kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike.

" Pavarësinë financiare dhe politike të radiotelevizionit publik.

" Reformën e Kodit Penal në lidhje me shpijën.

" Zhvillimin dhe rregullimin e medias 'online'.

Gjithashtu, gjatë këtyre 21 viteve, ne kemi ndjekur në vijimësi situatën dhe kemi ngritur zërin kur kemi parë që liria e medias, liria e shprehjes, ose siguria e gazetarëve janë vënë në rrezik, qoftë nga kërcënimet ndaj gazetarëve, deri të sulmet fizike, qoftë kur ka pasur nisim ligjore deri të reklamimi preferencial nga ana e qeverisë.

Thënë shkurt, Prezenca mbështet lirinë e medias si dhe zhvillimin e saj; diçka që dihet nga të gjithë gazetarët shqiptarë, si edhe nga partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Liria e medias ka përparuar përgjatë dhjetëvjeçarit të fundit, por ka ende shumë për t'u bërë.

" Shqipëria duhet të çkriminalizojë plotësisht shpijën. Ky është një rekomandim nga ne dhe nga ODIHR-i, në kuadrin e reformës zgjedhore. Edhe pse Kodi Penal nuk parashikon më dënim me burg për këtë veprë, gazetarët përballen me gjoba dhe dënime penale në rast se shpallen fajtorë.

" Dispozitat e Kodit Civil janë më se të mjaftueshme për të dënuar shpijën. Madje, edhe dispozitat e Kodit Civil mund të paraqesin rrezik dhe të frenojnë lirinë e shprehjes, nëse përdoren masivisht dhe si një sulm i gjerë kundër gazetarëve.



" Radiotelevizioni publik duhet të funksionojë i pandikuar nga kontrolli politik, pasi roli i tij i vërtetë është të jetë partner i qytetarëve, i vetë shtetit, si edhe i sektorit tregtar.

" Rregullimi i portaleve 'online', përfshirë portaleve të medias, është çështje e ditës. Ky rregullim duhet të kryhet duke respektuar plotësisht standardet ndërkombëtare, duke treguar kujdes dhe vëmendje për të mos cenuar lirinë e medias, përmes konsultimesh të gjera dhe transparente, si dhe duke respektuar parimin e përpjesëtuemërisë.

Prezenca e OSBE-së është e gatshme të ofrojë mbështetje përgjatë kësaj nisme dhe e mirëpresim angazhimin që kryeministri Rama shprehu dje në këtë drejtim, në takimin me përfaqësuesin e OSBE-së për Lirinë e Medias.

Nga ana tjetër, Prezenca e OSBE-së nxit profesionalizmin dhe përgjegjshmërinë e medias gjatë raportimit. Me sjellje etike dhe profesionalizëm, mediat dhe vetë gazetarët duhet të bëjnë pjesën e tyre për të arritur respektimin e lirisë së medias. Thënë troç: mos prisni nga politikanët të mbrojnë profesionin tuaj, këtë gjë duhet ta bëni vetë.

" Shoqatat e mediave, sindikatat e gazetarëve, pronarët e mediave duhet të përkrahin vetërregullimin e medias si alternativë ndaj rregullimit qeveritar të saj. Është më mirë të kemi një Kod Etike për Median, që respektohet dhe zbatohet, se sa dispozita të Kodit Penal.

" Dua të theksoj se liria e medias nuk nënkupton liri si në Perëndimin e Egër, liri nuk do të thotë anarki, liria e medias kërkon standarde profesionale, të

mishëruara në parime, rregulla dhe rregullore. Praktika më e mirë është që vetë gazetarët të hartojnë kode etike për median dhe t'i zbatojnë ato me anë të organizatave për vetërregullimin e medias.

" Nëse nuk veproni ndaj gazetarisë së kopjimit (copy/paste), nëse nuk ndërmerrni veprim sindikal ndaj informalitetit në punësim, nëse pranoi kontroll redaksional nga pronarët, atëherë edhe ju jeni përgjegjës për situatat me të cilat përballeni.

" Liria e medias dhe liria e shprehjes nuk mund të përdoren si shfajësim për të përhapur shpije dhe lajme të rreme, që u shkojnë për shtat interesave të caktuar politike dhe ekonomike. Edhe Prezenca e OSBE-së ka qenë vetë viktimë e këtyre sulmeve, prandaj e di mirë se ç'them.

" Kjo gjendje është veçanërisht problematike në rastin e me-

dias 'online' në Shqipëri.

" Ka me qindra faqe interneti që thjesht nxjerrin lajme pa cilësi, duke kopjuar trillime.

" Shumë informacione janë tejet të interpretueshme dhe mund të shihen si shpije, ndërsa informacione të tjera janë thjesht shpije dhe kaq.

" Pronësia e këtyre faqeve interneti shpesh është jotransparente. Është gjetur një në Kolumbi. Interesante...

" Burimet e financimit të këtyre faqeve janë të paqarta.

" Rregullimi i mediave 'online' është i nevojshëm, por kjo duhet bërë, sikurse thashë më herët, në mënyrë përpjesëtimore dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut përcakton standardet dhe udhëzimet.

Të nderuar pjesëmarrës!

Lejomëni të jem i qartë: Shqipëria sot është demokraci. Media dhe gazetarët këtu nuk përballen me kontrollin politik dhe me shtypjen e egër tipike të regjimeve diktatoriale ose autoritare. Ama, nuk duhet të fshehim as faktin që Shqipëria ka shumë rrugë për të bërë deri në hartimin, miratimin dhe zbatimin sistematik të standardeve më të mira në fushën e rregullimit të medias.

Vetë mediat shqiptare nuk kanë arritur atë nivel profesionalizmi, sjelljeje etike dhe vetërregullimi kolektiv, që është i domosdoshëm për pavarësinë dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Kur them pavarësi, e kam fjalën për pavarësi si nga forcat politike, ashtu edhe nga manjatët e medias.

Prandaj, jam i lumtur të shoh që forumi i sotëm po trajton problemet e vërteta, problemet e ditës, të medias në Shqipëri. I uroj këtij forumi përfundime të frytshme dhe shpresoj që ai do të shërbejë si nxitje e mëtejshme për përparimin e kauzës së lirisë të medias në Shqipëri.

\* Fjala e kryetarit të Prezencës në Shqipëri, ambasadorit Bernd Borchardt, në Forumin IV Vjetor për Zhvillimin e Medias

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NË MOBILE DHE TABLET

KERKONI NË APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NË KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NË APARATIN TUAJ



Analiza e Ditës

# Thesi 1.2 miliardë euro koncesione te rrugët

Nga Gjergj Erebara

(vijon nga faja 1)

... gjatë trembëdhjetë viteve të ardhshme dhe këto janë vetëm një pjesë e kontratave të shumta koncesionare të nënshkruara nga qeveria e shkuar dhe ajo aktuale.

Lista e investimeve publike të publikuar nga Ministria e Financave rendit kontratat koncesionare sipas koston që ka secila vit pas viti dhe sipas koston totale. Shifrat e dhëna nga kjo ministri përfshijnë koston e ndërtimit si dhe interesin financiar të paguar, i cili duket se nuk përfshihet në koston e tenderuar dhe të njohur më parë.

Interesi që pritet të paguhet për këto kontrata është mbajtur gjysmë i fshehtë dhe asnjë nga zyrtarët e qeverisë nuk ka marrë mundimin ta shpjegojë, siç duhet.

Kontrata e parë në listë lidhet me mirëmbajtjen e rrugës Milot-Morinë. Kjo kontratë financohet nga njëra anë nga përdoruesit e rrugës përmes tarifave dhe nga ana tjetër, nga taksapaguesit përmes dy zërave, njëri i njohur si "subvencionim" dhe tjetri i njohur si "defektet e fshehura të kontratës koncesionare". Për të dyja zërat, taksapaguesit do të paguajnë përgjatë viteve 9.1 miliardë lekë ose 73 milionë euro sipas kursit aktual të këmbimit. Këto janë veçmas të ardhurave të koncesionarit nga tarifat e rrugës.

Kontrata e dytë në listë është ajo e ndërtimit të 50 kilometrave rrugë që do të lidhë Tiranën me Dibërën. Ndërtimi i rrugës së Arbrit sipas rezultatit të tenderit të qeverisë kushton 40.3 miliardë lekë ose 320 milionë euro. Shqiptarët do të fillojnë të paguajnë 2.5 miliardë lekë në vit duke filluar nga viti 2019.

Kontrata e tretë është ndërtimi



i 21 kilometrave autostradë nga Vora në Kashar, për të cilën është parashikuar se do t'i kushtojë taksapaguesve 54.4 miliardë lekë (435 milionë euro). Me një kosto prej 20 milionë eurosh për kilometër ose 20 mijë euro për metër linearë, kjo është një kosto e krahasueshme me koston e ndërtimeve të tuneleve më të vështira kudo nëpër planet.

Mënyra e dhënies së kësaj kontrate koncesionare mund të tregojë diçka mbi arsyet e kësaj shume. Ajo fillon me një "proponim të pakërkuar" nga një kompani

private e quajtur Gener 2 dhe u pasua me një tender që efektivisht nuk kishte garë. Rezultati i tenderit prej 226 milionë euro nuk përfshin interesat që do të paguheshin mbi këtë shumë.

Segmenti i tretë në listë është dhënë, gjithashtu, me koncesion të pakërkuar dhe synon të ndërtojë 17.3 kilometra rrugë në segmentin Milot - Ballëren. Kostoja totale e parashikuar është 36.5 miliardë lekë ose 2.1 miliardë lekë për kilometër. Me kursin aktual të këmbimit kjo autostradë do të kushtojë 17.1 milionë euro për kilometër

ose 17 mijë euro për metër linear.

Segmenti i katërt është një rrugë dykalimëshe nga Orikumi për në Dukat. Me gjatësi prej 15 kilometrash, kostoja e ndërtimit të saj është 50 milionë euro, por kostoja totale bashkë me interesat është 11.8 miliardë lekë (94.4 milionë euro me kursin aktual).

Kontratat koncesionare të rrugëve do t'i kushtojnë taksapaguesve 3.3 miliardë lekë më 2019, 7 miliardë më 2020 dhe 8.3 miliardë lekë në vitin 2021, sipas parashikimeve të buxhetit të shtetit.

Reportera.l

## HOROSKOPI

### DASHI

Disa persona të shenjë së Dashit do të mendojnë për një ëndërr të vjetër. Përpikni që të mos humbisni mundësitë që do t'ju shfaqen sot. Për ta bërë këtë, duhet të filloni t'i besoni plotësisht intuitës suaj.

### DEMI

Sot do të dëgjoni shumë gjëra. Mos i besoni të gjitha thashethemet pa asnjë shkak. Nëse keni nisur diçka të re dhe të rëndësishme në jetë si për shembull një marrëdhënie apo projekt biznesi, atëherë kjo këshillë është e vlefshme.

### BINJAKET

Do të mendoni rreth mënyrës së duhur për të pasur sukses në punë dhe në jetën tuaj personale. Nëse i kushtoni vëmendjen e duhur kësaj çështje, mos bëni hapa pas. Duhet të përkushtoheni maksimalisht për të arritur qëllimet tuaja në jetë.

### GAFORJA

Disa persona të kësaj shenje do të kalojnë një ditë melankolie. Ka gjasa që të bëni një krahasim të së kaluarës suaj me të tashmen. Është e rëndësishme që të mos lejoni nostalgjinë t'ju kthehet në melankoli.

### LUANI

Sot do t'i kushtoni shumë rëndësi paraqitjes suaj. Ka gjasa që të gaboni gjatë një gjykimi. Mos u bëni sipërfaqësorë, sepse mund t'ju pengojë në rrugën drejt suksesit. Sa u përket marrëdhënieve romantike, sot mund të takoni një person shumë të veçantë.

### VIRGJERESHA

Mos u nxitoni, teksa jeni duke kryer detyra të rëndësishme, pasi mund të harroni disa detaje shumë të rëndësishme. Dëgjoni partnerin/partneren tuaj teksa ju flet dhe mos e ndërprisni për diçka tjetër. Ka gjasa që një mik të ketë nevojë për këshillën tuaj sot.

### PESHORJA

Ndoshta sot mund të ndryshoni ambientin në shtëpi, që do t'ju falë mjaft kënaqësi. Partneri/partnerja mund t'ju bëjë një surprizë sot. Mund të përfshihen në një konflikt në punë sot.

### AKREPI

Është e rëndësishme që sot të relaksoheni, pas një periudhe të lodhshme në punë. Gjendja juaj emocionale varet nga mënyra sesi do zgjidhni të veproni ndaj një çështjeje të caktuar. Disa persona të kësaj shenje, veçanësisht femrat, mund të përdorin paraqitjen e tyre për të përfunduar në një lojë mënyrë.

### SHIGJETARI

Mos u tregoni shumë kërkues ndaj vetes, por as ndaj të tjerëve. Pranoni këshillat e të afërme, por edhe të partnerit/partneres. Ka gjasa që një konflikt i vjetër të marrë fund dhe të nisni gjithçka nga fillimi.

### BRICJAPI

Sot do të përqendroheni maksimalisht në jetën tuaj personale. Do të zbuloni se dikush është shumë i interesuar për ju. Megjithatë, mendhuria mirë para se të ndërmerrni ndonjë hap të rëndësishëm, pasi mund të rezultojë që të mos jetë personi i duhur për ju.

### UJORI

Mund të ndiheni konfuz, pasi do të mendoni rreth disa ideve të reja. Do të kontaktoni me persona, të cilët do të tregohen të gatshëm të bashkëpunojnë me ju. Do të ishte mirë që përveç avantazheve të një projekti, të mendoni edhe rreth reziqeve të mundshme.

### PESHQIT

Mund të përfshihen në një situatë të papritur, e cila ka gjasa t'ju shqetësojë. Përpikni të mos lejoni disa persona të caktuar t'ju shkatërrin ditën. Përkundrazi, buzëqeshini personave që tentojnë t'ju ofendojnë, por njëkohësisht veproni me shpejtësi për të zgjidhur situatën.



## Mbrojtësi bluzi, deri në vitin 2020

### Atalanta rinovon edhe për një sezon me Gjimshitin

Berat Gjimshiti mund të vazhdojë të mendojë i qetë për fushën e lojës, pasi me paraqitjet që ka dhuruar në ato pak ndeshje sa ka luajtur me Atalantën, ka bindur klubin që t'i besojë për të paktën edhe një tjetër sezon.

Kontrata e mbrojtësit shqiptar përfundonte në mbyllje të këtij edicioni, por me sa duket palët kanë arritur akordin dhe sipas medieve italiane, ai ka rinovuar me Atalantën. Dy ditë më parë ishte menaxheri i tij, Alesio

Çekareli, ai që deklaroi se ishte një lojtar që vështirë se do të largohej nga Atalanta. "Ai është në bllokun e shënimeve të klubeve të ndryshme, por të shohim, sepse do të jetë e vështirë ta marrin nga Bergamo. Për Atal-

antën bëhet fjalë për një element thelbësor", deklaroi ai për "Gazzetta dello Sport". Në fakt, gjithçka është konkretizuar dhe, pasi mediat italiane kanë bërë të ditur se Gjimshiti ka zgatur edhe një vit marrëveshjen e tij me Atalantën. Kjo është një garanci më shumë për futbollistin që të vazhdojë të tregojë vlerat e tij dhe të sigurojë më pas një kontratë afatgjatë me klubin italian.

Pranon vështirësinë e trashëgimisë që i la Shehi në portë, por mendon se po e justifikon atë

# Teqja: Skënderbeu më i forti, në Tiranë veç për fitore

Portieri vlerëson mentalitetin e kampionëve në fuqi



Jeton Selimi

Të veshësh "dorezat" e Orges Shehit është e vështirë për këdo. Talenti, përvoja dhe dedikimi ndaj punës ishin elementët që e veçonin ish-portierin e Skënderbeut dhe të mbulojnë të njëjtin rol pas tij, duhet karakter dhe guxim. Trajneri aktual e bekoji si pasardhësin ideal dhe Aldo Teqja deri më tani nuk ka zhgënjyer askënd. Paraqitjet e 23-vjeçarit kanë qenë mjaft pozitive, megjithatë po ashtu si ish-kolegu, tashmë trajneri i tij Shehi, Teqja është mjaft kërkues ndaj vetes. "Të zëvendësosh Shehin është gjithmonë një përgjegjësi e madhe. Unë punoj çdo ditë e më shumë për t'u përmirësuar dhe për të justifikuar besimin e skuadrës ndaj meje", shprehet Teqja për "Supersport". Portieri është pjesë e Skënderbeut që nga viti 2016 dhe e ka përjetuar në vetë të



parë ndryshimin nga edicioni i shkurt tek ky sezon, gjithsesi një virtut ka mbetur

si paprekur, mendësia fituese e kampionëve në fuqi. Tiranë është kundër-

shtari i radhës dhe emri i bardhebluve të imponon respekt, por synimi i

Skënderbeut mbetet maksimal në transfertën e "Selman Stërmasit". "Është një transfertë e vështirë, pasi Tirana ka një skuadër mjaft të mirë dhe do të kërkojë rezultat pozitiv, por ne jemi Skënderbeu dhe do të luajmë për fitore, ashtu si në çdo takim", deklaroi portieri i bardhekuqe. Teqja e ka veshur fanellën kuqezi në të gjitha përfaqësueset e moshave dhe tek ajo e 21-vjeçarëve, portieri i Skënderbeut ëndërron Kombëtaren, por duke u bazuar gjithnjë te puna. "Unë jam i përqendruar të punoj sa më shumë dhe të përmirësohem, pasi jam i bindur se me paraqitje të mira, do të vijë edhe ftesa në Kombëtare, që është një ëndërr për të gjithë", u shpreh Teqja.

## BUNDESLIGA

Tifozët theyejnë klubet, ndryshon kalendari

Për shumë muajsh, tifozët e klubeve në Gjermani janë bashkuar në një protestë kundër Bundesligës. Ata nuk dëshirojnë më t'i shohin skuadrat e tyre në ndeshjet e së hënës në darkë, kur shumëkush nuk ka mundësinë t'i ndjekë në shtëpi apo transfertë, pasi luhet jashtë fundjavës tradicionale. Pas protestave e parullave të shumta që janë shfaqur në stadione, më në fund ata kanë arritur të bindin edhe klubet e Bundesligës, të cilët kanë gjetur akordin dhe duke filluar nga sezoni 2021/2022, nuk do të ketë më ndeshje të tilla të hënave. Disa grupe tifozësh kishin paralajmëruar bojkot të ndeshjeve në këtë sezon, pasi ishin të pakënaqur me sfidat e të hënës, ashtu si edhe me ato të së premtes në darkë. Por, më në fund klubet kanë dëgjuar apelin e tyre dhe kanë votuar ndryshimin e kalendarit. Fakti se ai do të hyjë në fuqi vetëm pas dy vitesh, është pasojë e kontratave ekzistuese me televizionet që nuk mund të prishen.

## SULMUESI ARGJENTINAS

### Dibala largon Bajernin: Kam objektiva për të arritur me Juventusin

Paolo Dibala shënoi golin e parë me Argjentinën në miqësoren kundër Meksikës. Ai u fut në fushë 10 minuta përpara fundit dhe arriti të linte shenjë të tij në këtë takim. 25-vjeçari është shfaqur shumë i lumtur pas takimit. Për "Bild", ai deklaroi se nuk është shumë i interesuar për merkaton dhe se prioriteti i tij është vetëm Juventusin. "Jam i lumtur që po luaj me Juventusin dhe kemi objektiva të mëdha për të arritur. Merkato nuk është shqetësim për mua, pasi nuk po mendoj për të. Mentaliteti i Joves është i njëjti, të fitojmë gjithçka", është shprehur Dibala. Kujtojmë se orët e fundit ka pasur interes për të nga Bajerni i Mynihut, por argjentinasi duket se po e shijon eksperiencën e tij, sidomos pas ardhjes së Ronaldos në ekip.

## UEFA zyrtarizon ndarjen e re

### Shqipëria humbet një vazo, bie në të katërtën

e parë bëjnë pjesë edhe 4 kombëtares që fituan grupet respektive të Ligës A në Ligën A të Ligës së Kombeve dhe për faktin se në qershor të 2019-ës, Holanda, Portugalia, Zvicra dhe Anglia do të diskutojnë mes tyre trofeun e parë të Nations League, në eliminatoret e 4-ta, këto përfaqësueset do të shorthohen në grupe me 5 ekipe. Gjermania është surpriza e vërtetë këtij shorti, pasi me barazimin e Polonisë ndaj Portugalisë, Kombëtarja e

pançerave ka zbritur në vazon e dytë dhe të gjithë duan ta evitojnë.

#### VAZOJA E PARË

Anglia, Portugali, Holanda, Zvicra, Spanja, Belgjika, Italia, Kroacia, Franca dhe Polonia.

#### VAZOJA E DYTË

Gjermania, Bosnja Hercegovina, Çekia, Danimarka, Islanda, Rusia, Suedia, Ukraina, Uells dhe Austria.

#### VAZOJA E TRETË

Finlanda, Irlanda e Veri-

ut, Norvegjia, Irlanda, Serbia, Sllovakia, Turqia, Bullgaria, Izraeli dhe Skocia.

#### VAZOJA E KATËRT

Shqipëria, Qipro, Estonia, Gjeorgji, Greqi, Lituani, Mali i Zi, Estoni, Hungari dhe Rumania.


#### VAZOJA E PESTË

Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Gjibraltari, Kazakistan, Kosova, Luksemburg, Maqedoni, Moldavi dhe Ishujt Faraore.

#### VAZOJA E GJASHTË

Andora, Letonia, Lihtenshtejti, San Marino dhe Malta.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Riza aktor.
7. Një fjalë si hijç.
11. Një mund të jetë diplomatik.
12. Premtom të bëhet as.
14. Janë felinë... të zinj.
16. Ami i Maupassant.
18. Heroi i Emilio Salgarit.
19. Qe anarkist i famshëm rus
21. Një mungesë gjaku.
22. Susanna shkrimtare
23. Të parat në cilësi.
25. Mbyllin një shtëpi.
26. Mbeten në fund.
27. Qendër në kaos.
28. Ka bërë piktoresk një i tillë
30. Inicialet e Camus.
31. Motra...e Kolë Idromenos
33. Një konfuzion total.
34. Rastet pa set.
36. Rastisin në krye.

37. Fillojnë detyrën.
38. Bektashi këngëtare.
39. Andrea aktore.
41. Sampras i tenisit.
43. Shkroi Korbi (indici).
44. Triplet e Trëndafilit me kredi.
46. Kilmer aktor.
47. Në krye të robotëve.
49. Unë dhe ti.
50. Një mund të jetë fetar.
51. Stephane poet francez

**VERTIKAL**

1. Fillojnë praktikën.
2. Britma e Arkimedit.
3. Ekstrema në trap.
4. Në fund të fundit.
5. Janë fjetoret e ushtarëve
6. Parker regjisor.
7. Vivaldi kompozitor.
8. Një shkop për karambol.
9. Janë firmat rentiere.
10. Një i fundit mbi të gjithë
11. Kufizojnë tatimet
13. Janë nomadë.
15. Panik pa kufij.
16. Fryn detin
17. Sidney regjisor i Serpico.
18. Jep alarmin.
20. Fillojnë nazet.
24. Janë llogari.
25. Alan regjisor.
29. Roman regjisor.
32. Eshhtë X ajo e sulmit.
33. Kapen të parat.
35. Një provë... inteligjence.
37. Një markë lap top.
40. Fillojnë matjet.
41. Rruga e Ferenc Molnar.
42. Qerre pa qe.
45. Fillojnë lirinë.
46. Fillojnë vallen.
48. Në mes të dhomës.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Një doktor... i Fritz Lang
6. U paraprind hoteleve.
11. Kush nuk ka... nuk ha
13. Eshhtë djall
14. Një mund të ketë i rralle.
15. Ishin perëndi të Samotrakias.
17. Institucione Botuese Autonome.
18. Eshhtë infeksion në bark
20. Fundi i një samurai.
21. Një markë kafeje.
22. Mbyllin një hark.
23. Mund të jetë emërore.
25. Ishite muzikanti që nuk përsiste.
28. Në krye të avokatëve.
29. Qerre pa qe.
30. Një pjesë e adoleshentëve.
32. Një banor imagjinar i planetit të kuq.
35. Nuk shuhej dot nga Tantal.

**VERTIKAL**


36. Desnuda e Goya-s.
37. Ruhet ajo sportive.
39. Vetëvrasia e samurait.
41. Drita pa kufizj.
43. Eshhtë ylli i skuadër.
44. I dashuri i Aidas.
46. Eshhtë zhurmë
47. Ishite lulja e harrësës.
1. James, armiku i Sherlock Holmes.
2. Eshhtë edhe ajo saudite.
3. Imami aktore
4. I kanë çift turket.
5. Inicialet e Seagal aktor.
6. Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
7. Në fund të lutjes.
8. Eshhtë sporti me stili të lirë.
9. Mbeten në fund.
10. Eshhtë rasti i veçantë, karakteristik.
12. Conan ai i Schwarzenegger.
13. Gjysmë ditari.
15. Mario, që qe bomber argjentinas.
16. Mund të prishej nga një... kleçkë.
18. Në hyrje të pistës.
19. Një numër... femrash.
21. Eshhtë qyteti i Besës
24. Qyteti që qehet edhe Sebaste.
26. Njëloj për latinët.
27. Mund të bëjnë stili të lirë.
31. Damon aktor.
33. Eshhtë pije e jona.
34. Në krye të noterëve.
36. Film i Robert Altman.
38. Skuadra merengue.
39. Një pjesë e hasmërisë.
40. Rralle është përgjysmë.
42. Nisur pa kufij.
45. Fillojnë mobilizimin.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

6		3						9
2	1		4	5	6			
	5	4			8	1		
	3	5		9	4			7
1	7			6				
	2		5					
		3	5	8		7		
						1	9	
8					1	5		

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

6	7	4	9	5	2	1	8	3
3	2	1	4	8	6	9	5	7
5	8	9	1	7	3	2	4	6
8	3	5	2	6	1	7	9	4
9	6	2	7	4	5	3	1	8
4	1	7	8	3	9	5	6	2
7	9	6	3	1	8	4	2	5
1	4	8	5	2	7	6	3	9
2	5	3	6	9	4	8	7	1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

-Me të njëjtën thjeshtësi që era çrrenjos një pemë të brishtë , tundimet tërheqin atë që është në kërkim të kënaqësive , që është i pangopur (lakmitar) , dembel dhe i dobët . Por , si era që nuk mund të lëkundë një mal , asnjë tundim nuk lëkund të urtin , energjikun , të besueshmin që jeton thjeshtë .

-Në këtë botë të gjithë do vdesim . Kujto , si mund të mbash armiqtësi ?

-Në këtë botë urrejja nuk mund t'i jap fund urrejtjes . Vetëm dashuria është e aftë ta shuajë atë . Ky është Ligji i Përfundshëm .

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

6	2	9	13	15	11	7	2	1	11	2	7	
4	9	12	4	11		2		14	13	15	8	2
1		12	4	2	12	4	11		6	1	8	
4	11	2			5	10	3	1	15		12	2
7	4	12		5	10	3	4	6	1	7	2	12
3			5	10	3	1	14	4	6	1		
4	12	2		5	1	7	2	12		11	4	3
7	10	6	10		14	4	8		12	10	7	4
12	11	1		9	4	12	6		8	15	8	
1	12		12	15	12	15		1	12	1		14
7	2	14	4	12		7	K'O'S'H		3	4		
4	12	1	7		9	4	7	9	4	11	4	12

- Jemi ajo që mendojmë . Ajo që jemi është produkt i mendjes sonë . Çdo fjalë ose vepër që lind nga ndonjë mendim i turbullt , ndiqet nga vuajtje , ashtu si rrota e karrës që ndjek këmbët e demit .
- Mos mbivlerëso atë që ke marrë dhe mos lakmo tjetër : Ai që lakmon tjetër nuk do arrijë paqen e mendjes .
- Kjo udhë Ariane me 8 rrugë , dmth : vizion i drejtë , qëllim i drejtë , fjalë e drejtë , veprim i drejtë , jetë e drejtë , përpjekje e drejtë , vëmendje e drejtë , meditim i drejtë .
- Këtë të vërtetat fshikë : të lindësh , të jetosh , të vdesësh , të ringjallësh .

*Thënie të mençura*

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

**FJALËKRYQI (1)**

M	A	R	I	E	K	O	H	A	A	K	
F	T	L	L	I	D	O	M	A	T	E	R
R	A	F	T	M	I	M	R	S	E		
A	A	P	E	R	I	P	A	T	I	M	
N	H	P	A	K	E	T	M	E	T	T	
Z	E	M	E	R	A	K	E	T	S	T	
T	E	I	D	A	N	E	T	V	E	T	
S	E	N	E	K	A	T	E	L	E	K	
S	E	N	E	K	A	T	E	L	E	K	
T	R	E	E	L	S	A	T	T			
L	I	V	E	T	A	K	A	A	D		
N	A	A	R	N	J	E	A	P	E	L	

**FJALËKRYQI (2)**

D	A	L	A	I	V	A	K	A	N	T	E	
E	D	E	N	P	N	A	D	I	A	M		
R	R	E	M	I	R	E	T	I	R	I	O	
T	E	S	T	R	T	A	T	E	O	L		
S	M	N	O	T	A	R	E	T	N	L		
K	A	H	P	A	M	E	R	I	K	A	N	E
E	H	P	A	M	O	A	D	S	H			
T	T	N	E	L	E	T	E	R	O	S		
O	R	A	N	E	T	A	K	E	T	O	S	
K	A	N	A	I	T	K	E	R	A	H	E	P
E	T	J	A	C	I	T	A	T	E	T	I	

